

ZGJEDHJA JUAJ



**ENTITETET POLITIKE QË
GAROJNË NË ZGJEDHJET PËR
KUVENDIN E KOSOVËS NË VITIN 2004
BROSHURA E ENTITETEVE POLITIKE**

Metodologjia në përpilimin e Broshurës së Entiteteve Politike

Broshura për entitetet politike është përpiluar në bashkëpunim në mes të Departmentit për Demokratizim të OSBE-së dhe Institutit Kosovar për Hulumtim dhe Dokumentim (KODI). Qëllimi i broshurës është ngritja e vetëdijes së votuesve kosovarë për mundësitë e tyre për të zgjedhur në votimet e ardhshme për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen më 23 tetor 2004.

Kjo broshurë përmban historikun e shkurtër të partive dhe iniciativave qytetare, biografite e shkurtëra të kryetarve të këtyre subjekteve politike si dhe biografite e shkurtëra të kandidatëve të pavarur që garojnë në këto zgjedhje. Në këtë broshurë gjithashtu janë të përfshira platformat e shkurtëra politike të entiteteve, në katër fusha kryesore: rinia dhe arsimi, zhvillimi ekonomik, shëndetësia dhe çështjet sociale, si dhe të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthimi. Detajet se ku mund t'i kontaktoni këto entitete janë dhënë për secilin prej entiteteve.

Të dhënat për entitetet politike janë dhënë dhe certifikuar nga vetë entitetet politike dhe nuk paraqesin opinionin e Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe të KODI-t. Përmbajtja e broshurës është një reflektim i asaj se si entitetet dëshirojnë të paraqesin veten para votuesit. Deklaratat e dhëna për këtë broshurë janë nënshkruar nga entitetet politike dhe në këtë formë nuk janë redaktuar e as ndryshuar nga OSBE-ja dhe KODI.

Radhitja në broshurë është bërë bazuar në numrin e entiteteve politike në fletëvotim, radhitje kjo e dalë nga hedhja e shortit. Secilës parti/iniciativë qytetare/kandidati të pavarur i është lënë nga një faqe për të siguruar mundësi të njëjta për të gjithë.

Përmbajtja:

	Faqe:
Parathënie	1
Sistemi zgjedhor dhe procedurat	2
Kuvendi i Kosovës	4
Entitetet politike	5
UNIKOMB	6
PNDSH	7
KOALICIONI VAKAT	8
Belul Beqaj	9
PSHDK	10
Fuad Ramiqi	11
GIS	12
BSDAK	13
PReK	14
IRDK	15
Riza Lluka	16
ADK	17
ORA	18
AAK	19
PSDK	20
PREBK	21
Ramë Dreshaj	22
GIG	23
BK	24
PDK	25
UD	26
LDK	27
KDTP	28
IQBKD	29
PD	30
PLK	31
Xhevdet Rexhaj	32
PDASHK	33
LPK	34
PDAK	35
SDA	36
PDI	37
Lista e çertifikuar e kandidatëve për zgjedhjet e vitit 2004	38

Parathënie nga Ambasadori Pascal Fieschi, Kryesues i Misionit të OSBE-së

Më 23 tetor, ju, votuesit, do ta keni mundësinë për të zgjedhur udhëheqësit tuaj në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës. Për shumë prej jush, kjo do të jetë hera e parë që e ushtroni të drejtën për të votuar. Për të tjerët, kjo do të jetë hera e katërt që nga viti 1999. Megjithatë, vlen të theksohet se pa marrë parasysh nëse votoni për herë të parë apo tanimë jeni votues me përvojë, këto zgjedhje dallojnë nga ato në të kaluarën.

Kosova ka ndryshuar jashtëzakonisht shumë në këto pesë vitet e fundit. Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes tanimë janë shndërruar në ofruar të mirëfilltë dhe kompetent të shërbimeve publike. Udhëheqësit e zgjedhur në Qeveri dhe Kuvend kanë ndikim në shumë aspekte të jetës sonë të përditshme. Kështu, ata kanë përgjegjësi për shumë fusha që kanë ndikim në jetën e njerëzve – duke filluar që nga politika ekonomike dhe mbrojtja e mjedisit të Kosovës e deri te arsimit dhe kultura. Njerëzit tuaj janë duke udhëhequr dhe kanë përgjegjësi ndaj jush.

Këto përgjegjësi të entiteteve politike dhe platformat e tyre janë më të rëndësishme se kurrë më parë. Prandaj, kjo e bën edhe zgjedhjen tuaj më të rëndësishme se kurrë më parë.

Në një shoqëri demokratike, zgjedhjet janë mundësia kryesore që shumica e njerëzve e kanë për të ndikuar në procesin politik. Së këndejmi, zgjedhjet për Kuvendin janë një mundësi që vota juaj të numërohet dhe që zëri juaj të dëgjohej.

Ndërkohë që kjo mundësi është një e drejtë fundamentale në shoqëritë bashkëkohore demokratike, sidoqoftë ajo është edhe një detyrim. Për të funksionuar demokracia në mënyrë të duhur, njerëzit duhet të votojnë. Prandaj, unë u bëj thirrje të gjithë atyre që i plotësojnë kushtet për të votuar, ta ushtrojnë këtë të drejtë.

Në këtë broshurë do të gjeni informata të përgjithshme mbi 32 entitete politike që do të marrin pjesë në zgjedhjet për Kuvend. Këto entitete politike, të cilat janë radhitur sipas renditjes së tyre në fletëvotime, e kanë prezantuar veten dhe njëherësh kanë shprehur qëndrimet e tyre për çështje të ndryshme. Me këtë rast, janë përfshirë çështjet që kanë të bëjnë me rininë dhe arsimin, zhvillimin ekonomik, shëndetësinë dhe çështjet sociale, si dhe të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthimin.

Kjo do t'ua bëjë të mundur që t'i krahasoni politikat e entiteteve politike ashtu siç i kanë prezantuar ato vetë. Zgjedhjet kanë rëndësi të jashtëzakonshme, ngase ju bëjnë të mundur që të zgjedhni dhe që këtë zgjedhje ta bëni bazuar në një informim të mirë dhe korrekt. Ndaj dhe shpresoj që kjo broshurë do t'ju ndihmojë gjatë këtij procesi dhe kësaj, do ta bëjë votën tuaj më kuptimplotë në ditën e zgjedhjeve.

SISTEMI DHE PROCEDURAT ZGJEDHORE

Më 23 tetor 2004, qytetarët e Kosovës do të kenë rastin të zgjedhin për herë të dytë deputetët e Kuvendit të Kosovës. Prandaj, secili që i ka së paku 18 vjet dhe është i regjistruar në regjistrin civil, ftohet për të zgjedhur deputetët e organit më të lartë të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes. Të 120 deputetët e Kuvendit do ta ushtrojnë mandatin e tyre për një periudhë trivjeçare. Votuesit kanë një zgjedhje mjaft të begatshme, ngase në këto zgjedhje do të garojë një numër i madh i entiteteve politike, partive politike, koalicioneve, iniciativave qytetare, por edhe i kandidatëve të pavarur. Pas zgjedhjeve, Kuvendi do ta zgjedh Qeverinë dhe kryetarin e Kosovës, do të debatojë dhe miratojë ligje dhe së këndejmi, në përgjithësi do të funksionojë si arena më e rëndësishme politike.

Zgjedhjet e 23 tetorit janë zgjedhjet e katërta me radhë që nga viti 1999 dhe njëherësh mundësia e dytë që qytetarët e Kosovës t'i zgjedhin përfaqësuesit e tyre në Kuvend. Sistemi zgjedhor me një zonë të vetme zgjedhore dhe me modelin proporcional me lista të mbyllura bazohet në rekomandimet e Grupit Punues të Zgjedhjeve (GPZ), një grup këshillëdhënës i përbërë nga anëtarët e partive kryesore politike në Kuvend si dhe nga shoqëria civile dhe përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare.

Nga aspekti elektoral, Kosova do të konsiderohet si një zonë e vetme zgjedhore ose si një zonë votimi, e cila nuk është e ndarë në nënzona të ndryshme zgjedhore. Me fjalë të tjera, dikush që për shembull jeton në Pejë, mund të votojë për të njëjtat entitete politike si dikush që jeton në Mitrovicë.

Sipas modelit të listave të mbyllura, votuesit mund të votojnë për një entitet politik (parti politike, koalicion, iniciativë qytetare ose kandidat të pavarur), dhe jo për një kandidat të caktuar të një entiteti politik. Megjithatë, emrat e kandidatëve do të shpallen në vendvotime në mënyrë që votuesit të informohen se cilët kandidatë konkurrojnë në listën e çdo entiteti politik.

Sipas sistemit proporcional, 100 ulëse të Kuvendit janë parashikuar për entitetet politike në proporcion me votat të cilat do t'i marrin.

Përveç kësaj, 20 ulëse janë të rezervuara për përfaqësuesit e komuniteteve kosovare joshqiptare. Sistemi i vendeve të rezervuara është zbatuar për herë të parë në vitin 2001, për ta siguruar përfaqësimin e komuniteteve më të vogla në Kuvend. Vendet e rezervuara ndahen në këtë mënyrë: dhjetë ulëse janë të rezervuara për komunitetin e serbëve të Kosovës në proporcion me numrin e votave të cilat i fitojnë në zgjedhje. Ndërsa, dhjetë ulëset e mbetura ndahen ndërmjet romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve (4), boshnjakëve (3), turqëve (2) dhe komunitetit goran (1).

Në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të vitit 2004 do të votojnë afro 1.3 milion¹ votues. Këtu përfshihen votuesit e ngjuar në shtëpi, njerëzit e hospitalizuar dhe të moshuar, të arrestuarit dhe njerëzit me aftësi të kufizuara mentale, të cilët do të votojnë përmes programit të posaçëm të votimit sikundër edhe votuesit në tridhjetë (30) vende të jashtme dhe në Serbi dhe Mal të Zi.

Për Zgjedhjet e vitit 2004 është rritur edhe numri i qendrave të votimit, në kuadër të përpjekjeve për të lehtësuar qasjen në këto qendra. Veç kësaj, listave të votuesve u është shtuar edhe një numër i votuesve të rinj, ndërsa të tjerët ia kanë dalur mbanë që t'i përtrijnë të dhënat e tyre. Regjistrat e votuesve ishin në dispozicion për inspektim publik dhe nga një kopje i është dhënë çdo entiteti politik që merr pjesë në zgjedhjet e këtij viti. Regjistri i qendrave të votimit është në dispozicion në webfaqet shumëgjuhëshe të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (www.ccc-ko.org) dhe në www.zgjedhjetekosoves.org.

Në ditën e zgjedhjeve, qendrat e votimit do të jenë të hapura nga ora 7:00 deri në orën 19:00. Nga të gjithë votuesit do të kërkohet që ta dëshmojnë identitetin e tyre edhe një herë me të arritur në vendvotim, përmes njërit prej dokumenteve në vijim: dokumentit të vlefshëm të identifikimit të lëshuar nga UNMIK-u (ID kartelën), dokumentit të vlefshëm të udhëtimit të lëshuar nga UNMIK-u, patentës së vlefshme të shoferit të lëshuar nga UNMIK-u, një karteletë të vlefshme të personit të zhvendosur ose një karteletë të vlefshme të refugjatit. Më pas, një anëtar i Komisionit të vendvotimit do ta verifikojë identitetin e votuesit dhe do ta kontrollojë emrin e votuesit

¹ Pritet konfirmimi përfundimtar

në regjistrin përfundimtar të votuesve. Çdo votues që gjendet në regjistër, duhet të nënshkruhet pranë emrit para se t'i jepet fletëvotimi në të cilin gjenden të gjitha entitetet politike (32), të cilat marrin pjesë në zgjedhje. Votuesi pastaj, do të hyjë në kabinën e votimit për të votuar në fshehtësi dhe, në fund, për ta hedhur fletëvotimin në kutinë e votimit.

Nëse votuesi me dokument të vlefshëm identifikimi nuk gjendet në regjistrin përfundimtar të votuesve, ai/ajo do të mund të votojë me kusht. Udhëzimet për votimin me kusht do t'i jepen votuesit nga anëtarë i Komisionit të vendvotimit.

Pas mbylljes së vendotimeve në orën 19:00 të shtunën, më 23 tetor 2004, Qendra e numërimit dhe e rezultateve do ta fillojë punën e vet. Të gjitha fletëvotimet, të rregullta, me kusht dhe ato jashtë Kosovës, do të numërohen në Kosovë. Sikur edhe në të gjitha zgjedhjet e mëhershme, vëzhguesve vendorë dhe ndërkombëtarë do t'u lejohet që ta vëzhgojnë numërimin. Pas certifikimit të rezultateve, kandidatët e suksesshëm do të bëhen anëtarët e posazgjedhur të Kuvendit të Kosovës.

Për më tepër informata mbi sistemin dhe procedurat zgjedhore ju lutemi kontaktoni:

Sekretariatit e KQZ-së
Prishtinë, Arbëri
Tel.&Fax: +381 38 240 722;
E-mail: cec.secretariat@cec-ko.org

ose vizitoni web-faqet në vijim:

www.cec-ko.org
www.kosovoelections.org
www.zgjedhjetekosoves.org
www.kosovskiizbori.org
www.osce.org/kosovo/elections

Ankesat dhe parashtrësit lidhur me procesin zgjedhor mund t'i drejtohen Komisionit të Zgjedhjeve për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP):

Eduard Liri 4
Arbëri
Prishtinë
Tel: +381 38 248 112
Fax: +381 38 248 113
E-mail: contact@ecac-ko.org
Web-faqja: <http://www.ecac-ko.org>

Kuvendi i Kosovës përfaqëson popullin e Kosovës

Sipas Kornizës Kushtetuese, Kuvendi i Kosovës është organi më i lartë përfaqësues dhe ligjvënës i Institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes (IPVQ). Kuvendi mund të hartojë dhe miratojë ligje, rekomandime dhe rezoluta në të gjitha fushat që janë nën përgjegjësinë e institucioneve të përkohshme. Këto përgjegjësi janë të përcaktuara me Kornizë Kushtetuese dhe në to bëjnë pjesë politikat ekonomike dhe financiare; çështjet buxhetore dhe fiskale; doganat; tregtia e brendshme dhe e jashtme, industria dhe investimet; arsimi, shkenca dhe teknologjia; rinia dhe sporti; transporti, posta dhe telekomunikacioni dhe teknologjia informative; shërbimi i administratës publike, të drejtat e njeriut, mundësitë e barabarta dhe të tjera. Me fjalë të tjera, Kuvendi i Kosovës tanimë ka një rol të rëndësishëm në krijimin e politikave në shumë fusha. Për më tepër, gjatë tri viteve të ardhshme dhe gjatë mandatit të Kuvendit të ri, këto përgjegjësi me gjasë do të zgjerohen dhe do të shtohen akoma më tepër.

Menjëherë pas zgjedhjeve dhe regjistrimit të anëtarëve të ri, Kuvendi do ta mbajë seancën e parë të tij.

Fillimisht, do të zgjedhen tetë anëtarë të Kryesisë nga radhët e së cilës do të zgjedhet kryetari i Kuvendit. Kryetari e përfaqëson Kuvendin, kryeson me mbledhjet e Kuvendit dhe ka për detyrë që të sigurojë respektimin e Rregullores së Punës së Kuvendit në tërësi. Njëherit, ai i kryeson edhe takimet e Kryesisë së Kuvendit, e cila është përgjegjëse për të gjitha çështjet organizative të punëve së Kuvendit, përfshirë këtu edhe rendin e ditës dhe kontaktet e jashtme parlamentare. Pastaj, Kuvendi do t'i emërojë edhe anëtarët për tri komisionet kryesore (buxhet; të drejta dhe interesa të komuniteteve; çështje gjyqësore, legjislativë dhe kornizë kushtetuese) dhe për komisionet funksionale. Këto organe të specializuara përbrenda Kuvendit janë jashtëzakonisht të rëndësishme për Kuvendin, ngase ato e kryejnë pjesën më të madhe të punës lidhur me hartimin dhe shqyrtimin e legjislacionit të ri si dhe mbështesin, nxisin dhe vëzhgojnë zbatimin e legjislacionit nga Qeveria.

Si hap të dytë, Kuvendi i posazgjedhur me shumicë votash dhe pas propozimit të kryetarit të Kosovës, do ta zgjedh kryeministrin dhe ministrat e Qeverisë së re të përkohshme.

S'do mend se Kuvendi i ri do t'i shfrytëzojë arritjet dhe përvojën e Kuvendit paraprak, mirëpo, mbetet ende shumë punë për t'u bërë. Kështu, ende ekziston një nevojë e madhe për hartimin e legjislacionit të cilësisë së lartë si edhe për mbikëqyrje më të afërt të punës së Qeverisë së përkohëshme, pikërisht për faktin se Kosova është në procesin e plotësimit të kërkesave, që dalin nga Plani për implementimin e standardeve për Kosovën, para shqyrtimit të tyre në vitin 2005.²

² Për më tepër informata lidhur me Kuvendin e Kosovës vizitoni faqen zyrtare të Kuvendit në adresën www.kuvendikosoves.org

Entitetet politike që garojnë në zgjedhjet për Kuvend në vitin 2004 e paraqesin vetveten.

Të dhënat për entitetet politike janë dhënë dhe çertifikuar nga vetë entitetet politike dhe nuk paraqesin opinionin e Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe të KODI-t.



31. PARTIA E UNITETIT KOMBËTAR SHQIPTAR - UNIKOMB

Historia e shkurtër: UNIKOMB-i është themeluar më 5 maj 1991 nga z. Halil Alidemaj. Më 1994 z. Ukshin Hoti zgjedhet kryetar i këtij entiteti politik, por më vonë ai burgoset dhe aktualisht ai konsiderohet peng i luftës. Që nga viti 2000 Muhamet Kelmendi, është kryetar i partisë. UNIKOMB-i që bërë pjesë e koalicionit me AAK-në dhe si rezultat në zgjedhjet e vitit 2001 fitoi një vend në Kuvendin e Kosovës. Më pas, UNIKOMB-i prishi koalicionin me AAK-në dhe aktualisht vepron si subjekt i pavarur politik.

Biografia e shkurtër e kryetarit: Dr. Muhamet Kelmendi është lindur më 18 nëntor 1953 në fshatin Llabjanë të Pejës. Ka kryer Fakultetin Juridik, më 1980 ka magjistruar dhe më 2004 ka doktoruar në shkencat juridike-politike. Paraprakisht, ka studiuar në Institutin e Evropës Juglindore në Hamburg të Gjermanisë dhe më vonë në Vjenë. Para se të bëhet anëtar dhe kryetar i UNIKOMB-it, ai ka qenë nënkryetar i Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK).

Pse do ta zgjedhte votuesi kosovar UNIKOMB-in?

Ajo që e dallon UNIKOMB-in, është angazhimi për realizimin e shtetit komb. Ky synim, sipas këtij subjekti krijon bazament për integrimin e pjesëve të ndara të kombit shqiptar në sferat politike, ekonomike – sociale. UNIKOMB-i mbështetë ndërtimin e shoqërisë demokratike e të lirë ku do të sundonte rendi dhe ligji, ku vullneti i popullit të Kosovës, do të ishte bazë e zgjidhjes së të gjitha problemeve.

Platforma politike

Rinia dhe arsimit:

E ardhmja e rinisë kosovare, bazuar në synimet e UNIKOMB-it, varet nga edukimi dhe profesionalizimi i saj. Këto çështje duhet të zgjidhen përmes reformave arsimore, të bazuara në Konventën e Bolonjës, por duke i përfillur specifikat e shoqërisë kosovare.

Zhvillimi ekonomik:

Ekonomia e Kosovës, sipas UNIKOMB-it, mund të dalë nga gjendja e shkatërruar tërësisht duke bërë funksionalizimin e subjekteve ekonomike, duke krijuar një politikë ekonomike afatmesme dhe afatgjate për Kosovën. Po ashtu, angazhohet për caktimin real të buxhetit të Kosovës, duke i mbrojtur prodhuesit vendorë kundruall atyre nga jashtë. Eksportit i kushtohet rëndësi prioritare. UNIKOMB-i angazhohet dhe për inkurajimin e investuesve të huaj dhe mbështetjen e ekonomive të vogla familjare.

Sëndetësia dhe çështjet sociale:

Shoqëria kosovare në tranzicion nuk mund të paramendohet pa një sigurim shëndetësor për të gjithë qytetarët e Kosovës, pavarësisht nga marrëdhënia e punës si dhe pa një program të fuqishëm të përkrahjes sociale. Kjo përkrahje duhet të përfshijë sigurimin shëndetësor për trajtimin mjekësor në të gjitha qendrat mjekësore, edhe në ato private, duke përfshirë dhe të gjitha medikamentet si dhe koston e mjekimit jashtë Kosovës, kur është i domosdoshëm. E tërë kjo procedurë, duhet rregulluar me ligj përkatës.

Të drejtat, interesat e komuniteteve dhe kthimi:

UNIKOMB-i deklorohet se është për një shoqëri tolerante e demokratike ku të gjithë qytetarët do të jenë të lirë e të barabartë pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike, fetare, gjinore apo krahinore. UNIKOMB-i pranon dhe përkrahë detyrimet që dalin nga Karta për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut. Bazuar në këtë dokumentet ndërkombëtar, kjo parti angazhohet që minoriteteve t' u garantohen këto drejta, sikundër edhe e drejta për kthim. Të gjithë ata që e pranojnë shtetin e Kosovës janë qytetarë të barabartë.

Kontakti: Rruga Pal Palucaj Nr.120, Prishtinë. unikomb@hotmail.com: Tel: +377 (0)44 127 925, Prishtinë



32. PARTIA NACIONAL DEMOKRATIKE SHQIPTARE - PNDSH

Historia e shkurtër e entitetit:

PNDSH është formuar më 3 maj të vitit 1992 në Prishtinë, si formacion politik i transformuar nga Lëvizja Nacional Demokratike Shqiptare, që ka vepruar për më tepër se 50 vjet. Kjo parti e veçon ruajtjen e kulturës, traditës dhe dinjitetit familjar si bërthamë të rëndësishme të shoqërisë demokratike liberale. PNDSH i përket spektrit të partive të djathta demokratike.

Biografia e shkurtër e kryetarit:

Z. Rexhep Abdullahu është lindur në Prishtinë, ku e kreu shkollën fillore dhe gjimnazin. Si student i mjekësisë në Beograd, burgoset më 31 janar 1956 me 34 veprimtarë të tjerë të LNDSH-së dhe dënohet me 12 vjet burg. Z. Abdullahu ka botuar librin, "Djathtizmi dhe demokracia në proces".

Pse do të zgjedhte votuesi kosovar PNDSH-në?

PNDSH qëndron prapa vlerave pro-perëndimore dhe pro-liberale dhe është kundërshtar i komunizmit, terrorizmit e racizmit. Ajo nuk pajtohet me qeverisjen e tashme e cila vepron vetëm me tri parti, të cilat nga interesat e tyre bëjnë koalicion në dëm të përballimit të sfidave tona.

Platforma politike

Rinia dhe arsimi:

PNDSH synon krijimin e kushteve që të rinjtë të jenë ndërtuesit e fatit të tyre dhe hapjen e perspektivës për shkollim duke u bazuar në reforma. PNDSH e vlerëson si prioritet në agjendën e vet punësimin e të rinjve.

Zhvillimi ekonomik:

PNDSH mbështetë ekonominë e tregut dhe konkurrencën, pronën private dhe përkushtimin e vëmendjes te zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla e të mesme. Poashtu, mbështetë investuesit nga jashtë si dhe investuesit vendor, përfshirë këtu prodhimtarinë vendore dhe lejimin e kredive financiare për ta.

Shëndetësia dhe çështjet sociale:

PNDSH aktualisht e mbështetë sektorin shtetëror të shëndetësisë, por në perspektivë angazhohet për zhvillimin e sektorit privat, por i cili do të kontrollohej nga organet legale. Angazhohet për aplikimin e sistemit të sigurimit shëndetësor, përkujdesjen ndaj invalidëve të luftës, hendikepuarve, përkujdesin ndaj fëmijëve bonjakë dhe shtresave të varfëra.

Të drejtat, interesat e komuniteteve dhe ktbimi:

Duke mbështetur zbatimin e ligjit dhe shtetit juridik, kjo parti është për barazi perspektivë për të gjitha etnitetet në Kosovë. Përkrahë kthimin e pjestarëve të zhvendosur nga komunitetet, sikurse edhe kthimin e të gjithë shqiptarëve të zhvendosur nga pjesa veriore e Mitrovicës.

Kontakti: Tel: +377 (0)44 150 602; pndsh@pndsh.com; www.pndsh.com



33. KOALICIJA VAKAT (Koalicioni VAKAT)

Historia e shkurtër:

Koalicioni VAKAT është themeluar në qershor të vitit 2004 nga tri parti, e ato janë: Partia Demokratike e Boshnjakëve (DSB), Partia Demokratike Vatan (DSV) dhe Partia Boshnjake e Kosovës (BSK), nga Prizreni, Dragashi dhe

Peja. Ky koalicion përfaqëson interesat e boshnjakëve të Kosovës (edhe të atyre që e deklarohen si Goranë).

Biografia e shkurtër e kryetarit:

Koalicioni ka një kryesues, mandati i të cilit zgjat 8 muaj. Gjatë mandatit të parë, kryesues do të jetë Gjezair Murati, kryetar i Partisë Demokratike të Boshnjakëve, nga Prizreni, i cili ka një përvojë të gjerë në politikë dhe jetën shoqërore, si dhe në luftën për të drejtat dhe interesat e boshnjakëve.

Pse do ta zgjedhte votuesi kosovar VAKAT-in?

Ne kemi dëshmuar se dimë si t'i mbrojmë dhe si të luftojmë për të drejtat dhe interesat e bashkësisë sonë. Ne këtë gjë e kemi bërë edhe para vitit 1999 dhe këtë e kemi vazhduar edhe pas luftës. Asnjëri nga personalitetet tona që na udhëheqin nuk ka qenë i përfshirë në punë ilegale apo në ndonjë incident me sjellje të pahijshme.

Platforma politike:

Rinia dhe arsimit:

- Hapja e fakulteteve dhe programeve akademike në arsimin e mesëm.
- Përkrahja dhe zbatimi i reformave në arsim.
- Ndihma për bursa studentëve të bashkësisë sonë.
- Ndërtimi të ambienteve sportive për fëmijë dhe për rininë.

Zhvillimi ekonomik:

- Hapja e vendeve të reja të punës.
- Mbështetja bizneseve të vogla dhe sipërmarrësve.
- Kthimi i pronës së uzurpuar komerciale dhe pronave të tjera.

Shëndetësia dhe çështja sociale:

- Krijimi i mundësive më të lehta të qasjes në përkujdesin shëndetësor më të mirë dhe më të lirë për pakicat.
- Hapja e qendrave të reja të shëndetësisë familjare.
- Rregullimi i të drejtave të punës.
- Rregullimi i statusit të pensionistëve dhe të invalidëve.

Të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthimi:

- Zbatimi i duhur i Kornizës Kushtetuese dhe Standardeve në pjesën ku flitet për të drejtat e pakicave.
- Kthimi i pakicave nga vendet e rajonit. Kthimi i atyre që gjenden në vendet e perëndimit të shtyhet për më vonë, përveç atyre që dëshirojnë të kthehen vullnetarisht dhe të cilët kanë gjendje të mirë financiare.

Kontakti: Tel: 044 200 915; 044 243 356; 044 327 293; email: aljabak54@yahoo.com



34. Belul Beqaj (kandidat i pavarur)

Biografia e shkurtër:

Z. Belul Beqaj është lindur më 14 qershor 1957 në Prizren. Ka kryer Fakultetin e Shkencave Politike në Beograd. Është baba i tre fëmijëve dhe jeton në Prishtinë që nga viti 1986. Belul Beqaj, në aktivitetin e tij profesional ka punuar në institucione të ndryshme me interes të veçantë. Pas dëbimit nga puna në vitin 1990 është marrë kryesisht me analiza politike. Ka qenë anëtar i Shoqatës së Politikologëve, editor i gazetës dhe revistës "Dita". Gjatë vitit 1999 ka qenë këshilltar politik i kryeministrit të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës. Z. Beqaj është kryetar i Federatës së Basketbollit, nënkryetar i Komitetit Olimpik dhe kryetar i Lëvizjes Evropiane në Kosovë.

Pse do ta zgjedhte votuesi kosovar z. Beqajn?

Qasja ndaj politikës dhe pushtetit ka rëndësi të veçantë. Politika është veprimtari racionale, e cila duhet të nisët nga fakti dhe realiteti e jo të ndërtohet nga baza iracionale, siç janë vullneti, dëshira, shpresa apo premtimi. Në periudhën 15 vjeçare, politika në Kosovë është ndërtuar mbrapsht. Prandaj ka ardhur koha për ndryshime: pushteti duhet të jetë në shërbim të qytetarit e jo të shërbehet me të.

Platforma politike

Rinia dhe arsimit:

Resursi më i rëndësishëm i Kosovës është rinia. Politika ka dështuar në aktivizimin e këtij resursi i cili do të mund të ishte lokomotivë e ndryshimeve pozitive. Në këtë situatë, z. Beqaj konsideron se qasja joadekuate në politikën e arsimit dhe punësimit mund të përkeqsojë gjendjen edhe më. Ai beson se për rininë nevojitet një qasje në nivel të vendit që të krijohet perspektivë për punësimin e tyre.

Zhvillimi ekonomik:

Kosovës, sipas kandidatit Beqaj, i mungon diagnostifikimi i potencialeve dhe prioritetëve ekonomike. Sektori i parë dhe i dytë i strukturës shoqërore ekonomike vepron me inercion dhe jo në bazë të planit. Ndërsa, sektori i tretë i shërbimeve vepron dobët ku janë përfshirë njerëz të padijshtëm e ku ka nepotizëm e jo profesionalizëm. Politika fiskale është stimuluese. Prandaj, ai e sheh krijimin e një strategjie afatmesme ekonomike si nevojë si dhe kualifikimin e kadrove të reja me një koncept krejt tjetër.

Shëndetësia dhe çështjet sociale:

Dështimet në shëndetësi dhe çështjet sociale, sipas kandidatit Belul Beqaj, janë të logjikshme, duke pasur parasysh dështimin ekonomik dhe menagjimin jokompetent. Ai angazhohet që këta dy sektorë të reformohen rrënjësisht, duke përfshirë edhe ndryshimet kadrovike.

Të drejtat, interesat e komuniteteve dhe kthimi:

Z. Belul Beqaj mbështetë krijimin e kushteve për ndërtimin e Kosovës si vend ku të gjithë qytetarët do të kenë të drejta të barabarta pavarësisht nga përkatësia nacionale, profesionale dhe gjinore. Z. Beqaj angazhohet që të krijohen kushte për kthim të qëndrueshëm të të zhvendosurve.

Kontakti: Rruga 9 Maji, 17/5, Prishtinë; Tel: +377 (0)44 127 726; 038 228 874



35. PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS - PSHDK

Historia e shkurtër

PSHDK është formuar më 1990. Gjatë këtyre 14 viteve, PSHDK ka bashkëpunuar me LDK-në për të promovuar pavarësinë e Kosovës brenda dhe jashtë vendit. PSHDK gjatë viteve '90 ishte forca e dytë politike në Kosovë. Ajo është parti kombëtare e orientuar drejt vlerave ideologjike demokristiane pa kurrëfarë dallimesh. PSHDK i takon krahut të djathtë të spektrit ideologjik dhe promovon vlerat pro-perëndimore dhe evropiane.

Biografia e shkurtër e kryetarit:

Akademik Mark Krasniqi është lindur në Shëngjon afër Pejës. Ka kryer gjimnazin në Prizren më 1941. Ka studiuar Letërsinë Botërore në Padovë të Italisë, kurse Gjeografinë dhe Etnologjinë në Beograd, ku ka diplomuar më 1950. Ka doktoruar në Lubjanë më 1960. Është profesor i Universitetit të Prishtinës dhe mbanë titullin akademik. Ka botuar më se 20 libra shkencorë, letrarë dhe poetikë. Aktualisht është deputet në Parlamentin e Kosovës.

Pozita kryesore në qeveri:

Ministër i Transportit dhe Post-Telekomunikacionit.

Pse do të zgjedhte votuesi kosovar PSHDK-në?

PSHDK-ja, është një prej atyre subjekteve të pakta që deklaroi haptas profilizimin e saj kah e djathta. PSHDK-ja është një parti demokratike, kombëtare, paqësore dhe e orientuar kah politika perëndimore. Qëllimi i saj është shteti i pavarur i Kosovës, i integruar në strukturat evro-atlantike, ku të gjithë banorët do të ndiheshin të barabartë.

Platforma politike

Rinia dhe arsimit:

PSHDK-ja angazhohet për procesin e reformave në të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë. Ajo mbështet vënieën e bazave të shkollimit të nivelit evropian dhe sigurimin e mjeteve financiare për shkollimin e të rinjve si në Kosovë ashtu edhe jashtë saj. Njëherësh, ky subjekt politik angazhohet edhe për hapjen e vendeve të reja të punës për të rinjtë kosovarë.

Zhvillimi ekonomik:

Përsheptimi i privatizimit, sigurimi i investimeve nga jashtë në Kosovë, zhvillimi i industrisë dhe shfrytëzimi racional i resurseve natyrore janë prioritetet e PSHDK-së në zhvillimin ekonomik. Ky subjekt politik mbështet krijimin e mundësive për derdhjen e kapitalit të diasporës në Kosovës.

Shëndetësia dhe çështjet sociale:

PSHDK angazhohet për ngritjen e infrastrukturës shëndetësore dhe avansimin e të gjitha kapaciteteve që çojnë drejt ngritjes së cilësive së ofrimit të ndihmave mjekësore, si në mjekësinë primare ashtu edhe në atë sekundare. Ajo është për një trajtim më human të rregulluar me ligj për të gjitha kategoritë, personat me aftësi të kufizuara, invalidët e punës dhe të luftës, pensionistët, personat e vetmuar dhe të gjitha shtresat me gjendje të rëndë sociale.

Të drejtat, interesat e komuniteteve dhe kthimi:

Ngritja e shtetit ligjor do të mundësonte krijimin e kushteve për kthim për të gjitha komunitetet. Në këtë aspekt, ajo angazhohet për garantimin e të drejtave njerëzore, të pronës, të drejtave kulturore, etnike e kombëtare për të gjitha komunitetet.

Kontakti: Rruga "Bedri Pejani", Prishtinë, www.pshdk-kosova.org; partia-demokristiane@hotmail.com

Tel: 038 221 536; +377 (0)44 194 378; +377 (0)44 124 303

Informacioni u sigurua nga: Mark Krasniqi, kryetar i PSHDK-së



36. Fuad Ramiqi (kandidat i pavarur)

Biografia e shkurtër:

Z. Fuad Ramiqi është lindur më 26 mars 1960 në Pozharan të komunës së Vitisë. Me profesion është oficer. Është i martuar dhe ka dy fëmijë. Jeton në Prishtinë.

Pse do të zgjedhte votuesi kosovar z. Ramiqi?

Si kandidat i pavarur, z. Fuad Ramiqi konsideron se është zëri i drejtpërdrejtë në Kuvend. Transparenca e plotë, mundësia që të votohet për individ dhe jo për parti politike është zgjedhje e kualitetit, që mbron interesin e elektoratit e jo të partisë.

Platforma politike

Rinia dhe arsimi:

Të drejtën e shkollimit sipas aftësive, të drejtën e punësimit dhe integritit në institucionet shtetërore, si dhe edukimi i vazhdueshëm qytetar kundër vlerave negative në shoqëri, janë fusha të fokusit të z. Fuad Ramiqi. Në këtë fushë, ai angazhohet edhe për futjen obligative të lëndës së edukatës fetare nëpër shkolla, për një kujdesje më të mirë për mësimdhënësit dhe për autonomi të plotë të Universitetit, duke e mbrojtur atë nga ndikimet politike e partiake.

Zhvillimi ekonomik:

Ekonomia familjare, stimulimi i bujqësisë dhe blegtorisë, aktivizimi i resurseve nëntokësore dhe industrisë, nga z. Ramiqi konsiderohen me prioritet të veçantë. Ndërsa ndërprerja e privatizimit, sipas tij, paraqet një sistem të dështuar, që është zbatuar përmes Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit.

Shëndetësia dhe çështjet sociale:

Ligji për shëndetësi duhet bazuar në përvojat evropiane. Gjendja e punëtorëve në shëndetësi dhe pacientëve duhet të përmirësohet. Z. Ramiqi promovon një shëndetësi të pavarur nga ndikimet politike e partiake. Gjithashtu, kushtet e institucioneve mjekësore duhet të përmirësohen dhe ato të pajisen me teknologji moderne. Të tregohet kujdes i veçantë për rastet sociale, sidomos për familjet e prekura nga lufta.

Të drejtat, interesat e komuniteteve dhe kthimi:

Të drejtat individuale për të gjithë në siguri, pronë, arsim dhe shëndetësi.

Kontakti: Bregu i Diellit Rruga 3 nr. 21, Prishtinë; Tel: +377 (0)44 111 534; 038 245 375; www.fuadramiqi.com

37. Gradanska Inicijativa Srbija – GIS (Inicijativa Qytetare Serbia)

Historia e shkurtër:

Z. Slavisha Petkoviç në vitin 2000 ka themeluar një asociacion të qytetarëve, të regjistruar në Serbi, qëllimi i së cilës ka qenë ndihma personave të zhvendosur nga Kosova. Si entitet politik, GIS-i është regjistruar për zgjedhjet për Kuvend në vitin 2004. Personat nga lista e kandidatëve kryesisht janë të zhvendosurit (70% të tyre janë nga qendrat kolektive të të zhvendosurve në Serbi) dhe vetëm dy kandidatë jetojnë tash në Kosovë.

Biografia e shkurtër e kryetarit:

Z. Petkoviçi u lind më 3 korrik 1966 në Ferizaj, ku edhe ka jetuar deri në qershor të vitit 1999. Që prej atëherë, ai jeton në Nish si i zhvendosur. Ka diplomuar në shkollën e mesme juridike në Ferizaj dhe në shkollën ekonomike në Prishtinë. Ka punuar dy vjet si përfaqësues i Qendrës Koordinuese për Kosovë në Mitrovicë.

Pse do të zgjedhte votuesi kosovar GIS-in?

GIS-i është përfaqësues autentik i serbëve të Kosovës e jo përfaqësues i partive të Beogradit.

Platforma politike:

Rinia dhe arsimit:

GIS-i është përkrahës i idesë se bashkësitë mund të afrohen njëra me tjetrën përmes arsimit. Bashkësitë duhet të studiojnë bazuar në programin mësimor dhe gjuhën e tyre. Këto programe mësimore duhet që në të ardhmen të shndërrohen në një program mësimor të vetëm dhe të mbahet në gjuhë të ndryshme, sipas gjuhëve të komuniteteve. Duke pasur parasysh disa dallime, arsimit duhet të bëhet brenda kornizës së një sistemi. Çfarëdo ndarjeje, e posaçërisht në arsim, do të çojë drejt ndasive të bashkësive të Kosovës.

Zhvillimi ekonomik:

Përdorimi i të gjitha burimeve të Kosovës që të mëkëmbet ekonomia. Futja në punë e të gjitha burimeve do të thotë edhe futja në punë edhe e të gjithë njerzëve, përfshirë këtu edhe pjesëtarët e bashkësive, për të siguruar të ardhura stabile për të gjithë, dhe me këtë tensionet zvogëlohen dhe rritet bashkëpunimi. Kosova është jashtëzakonisht e pasur me burime natyrore, posaçërisht me thëngjill dhe ka një potencial të madh për bujqësi, dhe nëse këto organizohen si duhet, atëherë Kosova mund të shndërrohet në aktor rëndësishëm rajonal si dhe eksportues.

Shëndetësia dhe çështjet sociale:

Sistemi i pensioneve është një çështje që mbetet e pazgjedhur për një kohë të gjatë. Shumë kompani shoqërore kanë të dhëna të gabuara apo nuk kanë të dhëna fare për numrin e viteve që punonjësit e tyre kanë punuar në to. Ky problem i madh është brengë e të gjitha bashkësive në Kosovë dhe kërkon një trajtim të posaçëm.

Sektori i shëndetësisë është i pajisur me teknologji të vjetëruar dhe ka shumë pak në numër qendra shëndetësore të shpërndara në Kosovë. Gjithashtu, ka një ndarje të ofrimit të shërbimeve shëndetësore në mes të shqiptarëve dhe serbëve dhe komuniteteve të tjera. Shërbimet shëndetësore duhet të bëhen në mënyrë të saktë bazuar në Betimin e Hipokratit: punonjësit mjekësorë duhet t'i trajtojnë pacientët pa bërë dallime në prejardhjen e tyre etnike apo religjioze.

Të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthimi:

Arsyeja kryesore pse GIS-i është regjistruar të marrë pjesë në zgjedhjet e tetorit është që të mund të ndihmojë në procesin e kthimit. Është koha e fundit që politikanët shqiptarë të Kosovës ta pranojnë plotësisht dhe pa rezervë procesin e kthimit. Liderët e ardhshëm të Kosovës kanë përgjegjësi të sqarojnë përse edhe pesë vjet pas përfundimit të konfliktit ka me mijëra të zhvendosur. GIS-i thekson fuqishëm se e vetmja mënyrë e kthimit është ajo që secili të kthehet në vendin e mëparshëm të banimit e jo të kthehet diku tjetër në Kosovë.

Kontakti: Sllavisha Petkoviç, tel: 063 881 21 58 and 064 306 56 30.



38. Bošnjačka Stranka Demokratske Akcije Kosova – BSDAK (Partia e Veprimit Demokratik Boshnjak e Kosovës)

Historia e shkurtër: Partia është themeluar në vitin 1990 kurse emrin kombëtar BSDAK e mori pas luftës, d.m.th. në vitin 2000. Ka marrë pjesë në të gjitha zgjedhjet e lira pas luftës, ku ka arritur një sukses të konsiderueshëm.

Biografia e shkurtër e kryetarit: Z. Hilmo Kandiq u lind në vitin 1959 në Meteh, në komunën e Plavës në Mal të Zi. Vendbanimi i tij është fshati Raoshiq, në komunën e Pejës. Ka diplomuar në Fakultetin e Bujqësisë. Para se të bëhet kryetar i BSDAK-së, z. Kandiq ka qenë anëtar i SDA-së së Kosovës që nga viti 1990 dhe ka qenë njëri nga nënkryetarët e partisë për shumë vjet. Ka qenë delegat i Kuvendit të Republikës së Kosovës në vitin 1991 dhe 1998. Në vitin 1998 ka qenë i propozuar për ministër të bujqësisë.

Postet kryesore në qeveri:

Këshilltar i ministrit të shëndetësisë në mandatin 2001-2004. Një vend në Kuvendin e Kosovës (delegat) si dhe pozita e anëtarit të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, që i është deleguar bashkësisë boshnjake në mandatin e tretë, post të cilin kjo parti nuk e ka marrë për arsye ende të paqarta për këtë parti.

Pse do të zgjedhte votuesi kosovar BSDAK-në?

Partia ofron një qasje të qytetëruar dhe evropiane të zgjedhjes së problemeve të bashkësisë së boshnjakëve dhe bashkësive të tjera që jetojnë në Kosovë.

Platforma politike:

Rinia dhe arsimit:

Që nga fillimi në vitin 2000, BSDAK-ja ka luftuar për sigurimin e arsimit në nivelin universitar për bashkësinë boshnjake në Kosovë. Ky do të jetë edhe qëndrimi kryesor edhe në mandatin e ardhshëm në çështjen e rinisë dhe arsimit.

Zhvillimi ekonomik:

Përkrahje dhe bashkëpunim me autoritetet që merren me çështjet e ekonomisë me qëllim të zhvillimit ekonomik në Kosovë. Përfaqësim proporcional të bashkësisë boshnjake në të gjitha institucionet e Kosovës.

Shëndetësia dhe çështjet sociale:

Krijimi i kushteve për kthimin dhe punësimin e mëtutjeshëm të mjekëve boshnjakë dhe personelit tjetër mjekësor në institucionet shëndetësore të Kosovës. Lehtësimi i qasjes në institucionet shëndetësore për bashkësinë boshnjake përmes sigurimit të përdorimit të gjuhës boshnjake në formularët mjekësorë në institucionet shëndetësore (në vendet ku jeton bashkësia boshnjake) dhe duke siguruar praninë e mjekëve boshnjakë dhe të personelit mjekësor boshnjak në sektorin e shëndetësisë.

Të drejtat dhe interesat e bashkësive dhe kthimi:

Zgjedhja e çështjes së pronës së uzurpuar. Kthimi i punëtorëve në vendet e tyre të punës, të humbura në periudhën pas luftës dhe sigurimi i të drejtave të cilat bashkësia boshnjake nuk i ka pasur as para luftës e fatkeqësisht as tani pas luftës së vitit 1999. Në përgjithësi, punë për t'u siguruar kushtet për kthimin e të gjithë atyre që dëshirojnë të kthehen.

Kontakti: Hilmo Kandiq, tel: 044 158 456; Shaqir Bajramović, sekretar i përgjithshëm, 044 158 464.



39. Partia e Re e Kosovës - PREK

Historia e shkurtë:

Partia e Re e Kosovës u themelua në prill të vitit 2002. Në zgjedhjet komunale të vitit 2002, PREK garoi në shtatë komuna, duke fituar vende në Prishtinë, Skënderaj dhe Suharekë.

Biografia e shkurtë e kryetarit:

Dr. Bujar Bukoshi është lindur më 13 maj 1947 në Suharekë, ku kreu shkollën fillore. Gjimnazin e kreu në Prizren, kurse Fakultetin e Mjekësisë në Beograd.

Në karrierën politike Bukoshi njihet si bashkëthemelues i LDK-së dhe KMDLNJ-së. Më 1991 zgjedhet kryeministër i Republikës së Kosovës dhe drejton qeverinë në mërgim (ekzil) gjatë viteve 1991-1999. Ka krijuar Fondin e Republikës së Kosovës. Në prill të vitit 2002 themeloi Partinë e Re të Kosovës. Nga gjuhët e huaja, dr. Bukoshi flet anglisht, gjermanisht dhe serbisht. Është i martuar, baba i 3 vajzave.

Pse do ta zgjedhte votuesi kosovar PREK-un?

Partia e Re e Kosovës është parti e qendrës së djathtë, parti e shtetit juridik dhe liberal. PREK angazhohet për një ekonomi të tregut të lirë dhe demokraci parlamentare ku sundon ligji, i cili mbron të drejtat dhe interesat e të gjithë qytetarëve. Ajo lufton dhunën dhe kriminalitetin me të gjitha mjetet që ka shteti juridik. Është kundër diskriminimit të femrës në shoqërinë kosovare. Angazhohet për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të njeriut, për tolerancë dhe mirëkuptim për të gjithë.

Platforma politike:

Rinia dhe arsimi:

PREK-u angazhohet që rinia të jetë sa më e përfshirë në jetën politike, institucionale e shoqërore në Kosovë. Do të angazhohet që Kosova të bëhet një ambient kulturor i përparuar dhe me një sistem bashkëkohor, që do t'i hapë rrugën integritit të saj në BE.

Zhvillimi ekonomik:

PREK do të dalë me programin e vet për zhvillimin e bujqësisë dhe ndërmarrjeve të vogla e të mesme.

Sbëndetësia dhe çështjet e tjera sociale:

PREK synon të arrijë reformë totale të sistemit shëndetësor.

Të drejtat, interesat e komuniteteve dhe ktbimi:

PREK mbështet të drejtat e barabarta për të gjithë qytetarët në vendin ku sundimi i ligjit do të mbizotërojë dhe ku do të ketë tolerancë etnike.

Kontakti: Rruga Tirana 43 A., Prishtinë; info@prek-kosova.org; www.prek-kosova.org



40. INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS - IRDK

Historia e shkurtër:

IRDK është themeluar në muajin prill të vitit 2001. Tani është parti parlamentare ka dy deputetë në Kuvendin e Kosovës. IRDK ka shtatë degë. Kryetar i saj është Bislam Hoti. Ky subjekt politik është i afërt me Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, me të cilën është në koalicion në kuadër të grupit parlamentar.

Biografia e shkurtër e kryetarit:

Bislam Hoti është lindur në vitin 1959 dhe ka të kryer shkollën e lartë. Është deputet në Kuvendin e Kosovës. Hoti është i martuar dhe ka katër fëmijë.

Pse do ta zgjedhte votuesi kosovar IRDK-në?

Kjo pari ka për qëllim afirmimin e identitetit kombëtar egjiptas, ruajtjen e traditës, kulturës dhe çdo gjë që lidhet me trashigiminë e këtij populli të lashtë. Partia gjithashtu synon zhvillimin dhe prosperitetin ekonomik të Kosovës. IRDK-ja synon të punojë për një Kosovë ku respektohet ligji dhe për formimin i institucioneve demokratike. Angazhohet për arsimim më të madh për popullatën egjiptase.

Platforma politike

Rinia dhe arsimi:

IRDK do të avokojë te Qeveria e Kosovës që t'u japë hapësirë dhe mundësi të rinjve egjiptas për shkollim sidomos në arsimimin superior.

Zhvillimi ekonomik:


Angazhimi kryesor në këtë fushë është zhvillimi ekonomik dhe një shkallë më e lartë e punësimit. Po ashtu edhe kthimin e popullatës dhe sigurimin e tyre, IRDK e thekson në agjendën e vet politike.

Shëndetësia dhe çështjet sociale:

Nisur nga fakti se pjesa më e madhe e komunitetit egjiptas jeton në varfëri të skajshme, ky subjekt politik angazhohet t'i kushtojë rëndësi të posaçme si shëndetësisë ashtu dhe sigurimit social.

Të drejtat, interesat e komuniteteve dhe kthimi:

Ky entitet politik prioritet kryesor ka mbrojtjen e interesave të komuniteteve dhe kthimin e njerëzve të pafajshëm në vendet e tyre dhe pronat e tyre.



41. Riza Lluka (kandidat i pavarur)

Biografi e shkurtër:

Riza Lluka, i lindur në vitin 1944, është inxhinier i ndërtimit. Delegat i Kuvendit të Kosovës 1982-1990 dhe anëtar e kryetar i Këshillit për urbanizëm dhe punë komunale në ish-Dhomën e Punës së Bashkuar të Kosovës. Lluka njihet dhe si kundërshtar i amandamenteve të Republikës së Serbisë me të cilat shuhej autonomia e atëhershme e ish-KSAK-së dhe ka votuar kundër këtyre ndryshimeve. Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, në kuadër të institucioneve paralele, por atëherë si anëtar i Partisë Parlamentare (1992-1998). Misionar në pajtimin e gjaqeve në SHBA në krye me Anton Çettën gjatë viteve të '90-ta. Z. Lluka është këshilltar komunal në Kuvendin Komunal të Pejës në mandatin 2002-2006.

Pse do ta zgjedhte votuesi kosovar z.Lluka?

Riza Lluka konsideron se është një veprimtar politik i qëndrueshëm dhe koherent në artikullimin e kërkesave dhe nevojave njerëzore, duke ofruar ide dhe shndërruar ato në praktikë. Duke besuar se ka vizion për të ardhmen, ai i ndërlidhë përvojat nga e kaluara, historia, më qëllim të veprimit të drejtë, human dhe në shërbim të njeriut.

Platforma politike

Rinia dhe arsimit:

Kandidati Lluka i kushton kujdes të veçantë arsimit, shtimit të rinisë shkollore e studentëve, stimulimi të tyre përmes angazhimit të strukturave të qeverisë dhe aktivizimit të të gjitha resurseve vendore e ndërkombëtare që të gjenden mjete për plotësimin e këtyre nevojave.

Zhvillimi ekonomik:

Z. Lluka angazhohet në veçanti për aktivizimin e tërë potencialeve ekzistuese të Kosovës. Për këtë qëllim nevojitet një shqyrtim i mundësive reale të kapaciteteve prodhuese dhe të vlerësimit të resurseve natyrore në Kosovë. Si investoret e vendit ashtu edhe ata të huaj duhet të stimulohen.

Shëndetësia dhe çështjet sociale:

Niveli i tanishëm i shëndetësisë është shumë i ulët dhe ka shumë çështje të pajzgjdhura sociale në Kosovë. Mu për këtë, është detyrë parësore e z. Lluka, që të shtojë angazhimin, për të siguruar një kujdes më të madh për shëndetin e shtresave të rrezikuara të popullatës dhe për zgjidhjen e çështjeve më elementare sociale në mënyrën më urgjente.

Të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthimi:

Si kandidat i pavarur, ai deklarohet të kujdeset që njeriu dhe të drejtat e tij si individ dhe pjesëtar i komunitetit të jetë në qendër të vëmendjes së strukturave shtetërore, duke u bazuar në konventat ndërkombëtare. Lidhur me kthimin, z. Riza Lluka beson se duhet kthyer të gjithë ata që nuk kanë kryer vepra kriminale të motivuara etnikisht. Çdo revanshizëm i shumicës është i papranueshëm dhe i ndëshkueshëm. Ai mbështet bashkëjetesën e të gjitha komuniteteve në Kosovë.

Kontakti: Rr."Shaban Spahiaja" nr. 108, Pejë; Mob: 377 (0)44 149 405; Tel: 039 33850/ 31 601; rizalluka@yahoo.com; kontakt@rizalluka.com; www.rizalluka.com



42. Alternativa Demokratike e Kosovës - ADK

Historia e shkurtër: ADK është parti e re politike, e themeluar më 16 maj të vitit 2004. Është formuar nga një grup politikanësh, intelektualësh dhe studentësh, të cilët kanë parë nevojën për ndryshime pozitive në Kosovë. ADK i vë vlerat njerëzore të ndërtuara mbi kriteret e ndershmërisë, aftësisë dhe përgjegjshmërisë si prioritet. Menaxhimin strategjik të kapitalit njerëzor, e cilëson si interes nacional të Kosovës. ADK angazhohet për një shoqëri të bazuar në parimin e mundësive të barabarta.

Biografia e shkurtër e kryetarit: Edita Tahiri është shkolluar në Universitetin e Harvardit. Ajo është magjistër i Administratës Publike. Arsimiti paraprak i saj është inxhinierë e Elektronikës dhe Telekomunikimit. Gjatë të nëntëdhjetave Tahiri ishte sekretare për marrëdhënie me jashtë në LDK. Është një prej pjesëmarrësve në procesin negociator të Rambujesë. Edita Tahiri është dhe deputete në Kuvendin e Kosovës (2001 – 2004).

Pse do ta zgjedhte votuesi kosovar ADK-në?

Ky subjekt i ri politik, por me njerëz të njohur nga skena politike, deklarohet për nevojën e zbutjes së plagëve të luftës dhe ndriçimin e fatit të personave të pagjetur të luftës. ADK vihet në mbrojtje të vlerave të lëvizjes për pavarësi. Ajo është parti moderne e qendrës që synon politikë të re e vizionare, e aftë t'u përgjigjet kërkesave të qytetarëve në përmbushjen e vullnetit të popullit të Kosovës për pavarësi si dhe t'i përballojë sfidat e ndryshimeve globale.

Platforma politike

Rinia dhe arsimiti:

Kjo parti, synon që t'i përfillë pikpamjet e rinisë në ndërtimin e vizionit për të ardhmen e Kosovës. ADK do të punojë që rinia të përfaqësohet me 40 përqind në administratën publike. Gjithashtu, ADK e konsideron zhvillimin e një sistemi cilësor arsimor si interes nacional të Kosovës.

Zhvillimi ekonomik:

ADK i jep përparësi prosperitetit ekonomik dhe krijimit të vendeve të reja të punës. Ajo mbështetë formulën e vënies së kapitalit njerëzor në ekonominë e tregut, si dhe krijimin e një mjedisi të favorshëm dhe të sigurt për investime dhe mekanizma adekuatë për ta luftuar korrupsionin.

Shëndetësia dhe çështjet sociale:

ADK synon reformimin e sistemit shëndetësor, duke krijuar shërbime më cilësore dhe forcuar kapacitetet planifikuese në politikat e zhvillimit të fushës së shëndetit publik. Gjithashtu, ADK angazhohet për forcimin e infrastrukturës shëndetësore, sidomos shtrirjen në zona rurale.

Të drejtat, interesat e komuniteteve dhe kthimi:

ADK angazhohet për promovimin e marrëdhënieve të mira ndëretnike në Kosovë dhe rajon. Të drejtat e qytetarëve dhe të minoriteteve, ky subjekt politik mëton t'i realizojë mbi bazat e vëna në dokumentet relevante ndërkombëtare duke u angazhuar njëkohësisht që t'i integrojë pakicat në jetën shoqërore e institucionale. Kthimi i refugjatëve, për ADK-në është një çështje e rëndësishme e cila në radhë të parë kushtëzohet nga zhvillimi ekonomik.

Kontakti: Hotel "Iliria", rruga "Nënë Tereza"; Prishtinë; alternative_demokratike@hotmail.com; alternative_demokratike@yahoo.com; Tel: 038 247 248; +377 (0)44 160 753



43. Lista Qytetare ORA

Historia e shkurtër: Lista Qytetare ORA është një forcë politike reformiste. Synimi i saj është nxjerrja e Kosovës nga rrethi i mbyllur i stagnimit dhe i degradimit dhe ta shpiejmë në drejtim të një shoqërie bashkëkohore perëndimore. Kryetar i ORA-s

është z. Ylber Hysa.

Biografia e shkurtër: Z. Veton Surroi është kryesuesi i listës së ORA-s. Ai është lindur në Prishtinë më 1961. Është themelues i shtëpisë mediale "Koha", botues i gazetës "Koha Ditore" dhe televizionit "KTV". Ka diplomuar në Fakultetin e Filozofisë dhe Literaturës në Universitetin Kombëtar të Pavarur në Mexico City. Z. Surroi ishte pjesëmarrës i grupit negociues shqiptar në bisedimet në Rambouillet dhe Paris (1999).

Pse do ta zgjedhte votuesi Kosovarë ORA-n?

ORA vlerëson se koalicioni i tashëm qeveritar në Kosovë nuk ka qenë në gjendje t'i përbushë as nevojat themelore të qytetarëve siç janë rryma dhe uji dhe ka bërë shumë pak për sigurinë e përgjithshme dhe krijimin e një ekonomie funksionale. Për më tutje, dështimet e liderve politikë në sferat e zakonshme të jetës në Kosovë e kanë rrezikuar seriozisht çështjen e pavarësisë së Kosovës që duhet të hapet në 2005. ORA është subjekt politik që synon të shërbejë e jo të sundojë mbi qytetarët e Kosovës në realizimin e aspiratave të tyre politike.

Platforma politike:

Rinia dhe arsimi: **Ligjet – Sundimi i zotit të shtëpisë**

Brenda 12 muajsh Kosova duhet ta unifikojë sistemin e vet ligjor, në tërë territorin e saj. Ligj themelor i Kosovës duhet të jetë Kushtetuta e saj. Në bazë të të drejtave të përfituara, Kosova do t'i harmonizojë ligjet e veta me ato të Bashkimit Evropian. Përgjegjësinë themelore për qeverisjen në Kosovë e marrin vetë kosovarët në të gjitha fushat. Përrjashtim janë çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe nënshkrimin e marrëveshjeve të karakterit ndërshtetëror - deri në përcaktimin e statusit të përhershëm. Krijohet partneriteti i ri me UNMIK-un dhe njëkohësisht sistem llogaridhënieje i autoriteteve kosovare ndaj qytetarëve të tyre. Vihet në funksion fuqizimi i pushtetit lokal në vendimmarrje (decentralizimi).

Zhvillimi ekonomik: **Ekonomia – paraja e vendit**

Brenda 12 muajsh Kosova do ta ketë sistemin e vet ekonomik. Prona e saj shoqërore menaxhohet nga Qeveria e Kosovës, ndërsa ligji për privatizim miratohet nga Parlamenti i Kosovës. Të ardhurat nga privatizimi hyjnë në qarkullim brenda sistemit financiar të vendit. Stimulohet prodhimi vendor. Të ardhurat buxhetore vilen në shumicë prej qarkullimit të brendshëm e jo prej importeve.

Shtëndëtesia dhe çështjet sociale: **Partneriteti për punë dhe kundër varfërisë**

Nëpërmjet stimulimeve fiskale, doganore dhe infrastrukturore, renovimi ekonomik i Kosovës do të bëhet duke krijuar vende të reja të punës. Qeveria do të ndërtojë partneritet me komunitetin afarist, atë bankar dhe me pushtetin lokal për t'i realizuar objektivat e punësimit. Me stimulime të projekteve infrastrukturore e me prioritetet zhvillimore, duhet përgjysmuar brenda periudhës qeverisëse numrin e qytetarëve që jetojnë në varfëri të skajshme, me perspektivë zhdukjeje të kësaj kategorie.

Kontakti për publikun: ORA; Bulevardi Nënë Tereza 29/3, Prishtinë, Kosovë; Tel: 038 246 600; Fax: 038 243 457; info@ora-kosova.org; www.ora-kosova.org



44. ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS - AAK

Historia e shkurtër: AAK u themelua si koalicion i partive politike dhe lëvizjeve politike, kombëtare e qytetare në vitin 2000. Më 2002, ajo u transformua në parti politike. AAK qeverisë në disa komuna, vetëm ose në koalicion me parti të tjera. Kjo parti qeverisë Kosovën në koalicion me dy parti të tjera, që nga zgjedhjet e vitit 2002.

Biografia e shkurtë e kryetarit: Z. Ramush Haradinaj u lind më 3 korrik 1968 në Glogjan. Me profesion është jurist. Gjatë luftës në Kosovë z. Haradinaj ishte komandant i Zonës së Tretë Operative të Dukagjinit. Ai është drejtues i AAK-së që nga 2 maji të vitit 2000. Është i martuar, baba i një fëmije.

Postet kryesore në qeveri: Ministër i Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor dhe ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Pse do ta zgjedhte votuesi kosovar AAK-në? Pragmatizmi, efektshmëria në qeverisje, transparenca në udhëheqje, AAK është një parti që e bashkon dhe nuk e ndanë skenën politike, AAK është një parti që i mban premtimet.

Platforma politike:

Rinia dhe arsimi:

1. Rinia duhet të jetë e aftë të vendosë për vetveten.
2. Hartimi i strategjisë afatgjate për arsimin dhe reforma rrënjësore në arsim.
3. Përfshirje më e madhe e fëmijëve në institucionet parashkollore.
4. Arsimi i shkollës së mesme duhet të profesionalizohet për të qenë në hap me kërkesat ekonomike të Kosovës.
5. Stop politizimit të Universitetit të Kosovës.

Zhvillimi ekonomik:

1. Planifikimi i strategjisë globale për zhvillimin ekonomik të Kosovës.
2. Partneritet strategjik me organizatat ndërkombëtare komerciale dhe financiare.
3. Përkrahje ligjore për prodhuesit vendorë.
4. Krijimi i bizneseve të reja të vogla dhe të mesme.
5. Ndihmë për ekonomitë shtëpiake.
6. Zhvillimi i infrastrukturës (rrugët dhe telekomunikacioni) dhe korridori Prishtinë – Prizren – Durrës.

Shëndetësia dhe çështjet e tjera sociale:

1. Përfshirja e arritjeve moderne nga fusha e mjekësisë; përdorimi i metodave të avancuara dhe bashkëkohore në mjekimin e pacientëve; pajisje me teknologji moderne; administrim transparent të sistemit shëndetësor.
2. AAK është duke e formuluar një politikë të re sociale; reformimi i fondit publik pensional; një rol i ri për shtetin në definimin e politikave sociale.

Të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthimi:

Sigurimi i kthimit të të gjithë atyre qytetarëve të Kosovës që dëshirojnë të jetojnë në Kosovën e re.

Kontakti: Bulevardi i Dëshmorëve, nr. 49, Prishtinë, Tel. & fax. 038/ 548 322; aak_info@yahoo.com; www.aleanca.com

Informacioni u sigurua nga: Jahja Lluka, anëtar i Kryesisë së AAK-së



45. PARTIA SOCIALDEMOKRATE E KOSOVËS - PSDK

Historia e shkurtër:

PSDK u themelua më 12 shkurt 1990. Ajo ishte e përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës gjatë viteve të '90-ta. PSDK-ja është parti e qendrës së majtë me ideologji socialdemokrate, të ngjashme me partitë socialdemokrate në Gjermani

dhe Suedi.

Biografia e shkurtër e kryetarit:

Znj. Kaqusha Jashari është inxhinieri e diplomuar. Në jetën politike të Kosovës është aktive që nga viti 1970. Ka mbajtur poste të rëndësishme edhe në periudhën e komunizmit. Ishte kryetare e Lidhjes së Komunistëve të Kosovës. Ajo njihet si kundërshtarë e hapur e politikës së Slobodan Milosheviqit në Kosovë, gjatë fundviteve të '80-ta.

Pse do ta zgjedhte votuesi kosovar PSDK-në?

PSDK deklarohet për angazhimin e saj në krijimin e tolerancës civilizuese. Ajo ka një program zhvillimi të qëndrueshëm si dhe vizione të reja. Në qendër të vëmendjes së politikës së saj vë njeriun-qytetarin dhe mirëqenien e tij, duke promovuar të drejtat e garantuara dhe të mbrojtura nga institucionet e shtetit juridik. Ligjshmëria sipas PSDK-së, duhet të jetë bazë nga burojnë liritë nacionale e fetare.

Platforma politike

Rinia dhe arsimit:

Përmes ngritjes së një sistemi arsimor të reformuar, kompatibil me sistemin arsimor evropian, PSDK synon një perspektivë për rininë kosovare. Arsimit nuk duhet të bazohet vetëm në tregun e punës, por edhe në shkencat shoqërore e teknologjike, që përkrahin progresin në teknologji dhe informatikë.

Zhvillimi ekonomik:

Privatizimi dhe ristrukturimi i ekonomisë janë prioritet për PSDK-në. Privatizimi do të mundësojë investimin e kapitalit të vendit dhe nga jashtë, me qëllim të punësimit, specializimit të kuadrove dhe shfrytëzimit të resurseve ekzistuese. Privatizimi do të sigurojë një zhvillim të gjithëmbarshtëm ekonomik, social e kulturor të Kosovës.

Shëndetësia dhe çështjet sociale:

PSDK avokon për politikën e zhvillimit ekonomik në bazë të ekonomisë së tregut, me privatizimin e pronës dhe me një sistem fiskal të avancuar. Vetëm atëherë do të krijohen kushtet për vetëfinancim nga buxheti i sferave më të ndieshme të shoqërisë, siç janë, shëndetësia, pensionistët, invalidët e luftës, shkollimi, sporti, kultura, ekologjia dhe veprimtari që krijojnë siguri personale dhe sociale të qytetarëve.

Të drejtat, interesat e komuniteteve dhe kthimi:

Një demokraci e ardhshme funksionale në Kosovë, sipas PSDK-së, mund të ndërtohet me participimin e të gjitha potencialeve shoqërore, duke lënë prapa primitivizmin dhe urrejtjen. Shoqëria civile duhet të forcohet dhe në të njëjtën kohë kapacitetet demokratike të shoqërisë duhet të ngriten duke e depolitizuar arsimin, shëndetësinë, policinë dhe Trupat e Mbrojtjes së Kosovës.

Kontakti: Tel: 038 542 009; www.psdk.org; info@psdk.org



46. PARTIA ROMË E BASHKUAR E KOSOVËS – PREBK

Historia e shkurtër: PREBK u themelua në verën e vitit 2000 dhe selinë e ka në Prizren. Kjo parti angazhohet për përmirësimin dhe avancimin e sigurisë, të drejtave dhe punësimit të pjesëtarëve të komunitetit rom. PREBK është anëtare e Unionit Botëror Rom (RUW), ndërsa kryetari i PREBK-së është anëtar i këtij Unioni.

Biografia e shkurtër e kryetarit: Z. Haxhi Zulfi Merxha u lind më 10 shkurt 1934 në Prizren. Ai punoi për 32 vjet në fabrikën e tesktilit "Printeks" në Prizren, ku edhe u pensionua si Shef i Seksionit për Produkte Finale. Ai ka mbaruar shkollën e mesme të lartë të tesktilit në Leskovc.

Postet kryesore në qeveri:

Anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës në vitin 2001.

Pse do ta zgjedhte votuesi kosovar PREBK-në?

PREBK nuk ka ambicie për të qeverisur, ngase është parti e vogël dhe e varfër. Në vend të kësaj, ne angazhohemi për respektimin e të drejtave njerëzore dhe demokratizimin e Kosovës. PREBK i pranon në tërësi Standardet për Kosovën dhe është gjithnjë njëqind përqind e përkushtuar për pjesëmarrje në zgjedhje.

Platforma politike:

Rinia dhe arsimit:

PREBK synon përfshirjen e romëve në Universitet dhe shtimin e pranisë së romëve nëpër shkollat e mesme. Për t'u bërë qytetarë të barabartë, pjesëtarët e komunitetit rom lypset që të shkollohen në numër sa më të madh.

Zhvillimi ekonomik:

Situata ekonomike e romëve është "nën nivelin zero". PREBK mëton që ta zgjidh këtë problem përmes shkollimit sa më të madh, gjë e cila do t'i hap shteg shtimit të punësimit. Gjer më tani, në të dy këto fusha romët janë shpërfillur. Kjo parti angazhohet për një program të veçantë ekonomik dhe të punësimit për komunitetin rom të Kosovës.

Shëndetësia dhe çështjet sociale:

Pjesa dërrmuese e romëve janë të papunë, ndaj dhe të ardhurat e tyre në përgjithësi janë shumë të ulëta. Kështu, për shkak të kushteve të mjera të jetesës tash është përhapur me të madhe edhe tuberkulozi në mesin e romëve. Së këndejmi, PREBK do të avokojë për më tepër angazhim të autoriteteve dhe institucioneve shëndetësore përkitazi me problemet e veçanta shëndetësore të romëve. PREBK do të impenjohet për formimin e një komisioni të veçantë, i cili do të merret me problemet shëndetësore të romëve.

Të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe ktbimi:

Për të bërë të mundur kthimin e të gjithë romëve në Kosovë si dhe integrimin e tyre në shoqëri, së pari duhet të krijohen kushte të përshtatshme për romët që janë duke jetuar në Kosovë. Kështu, para së gjithash "enklavat" duhet të shpërbëhen, duhet të sigurohet lëvizja e lirë dhe duhet të rindërtohen shtëpitë e shkatërruara të romëve. Së këndejmi, kthimi i romëve të zhvendosur mund të arrihet vetëm atëherë kur të përmirësohet situata e sigurisë, të zgjidhen çështjet pronësore dhe kur popullata në përgjithësi të jetë e gatshme që t'i pranojë romët.

Kontakti: Daut Qylangjiu, tel.: 044 229 192.



47. Ramë Dreshaj (kandidat i pavarur)

Historia e shkurtër:

Z. Ramë Dreshaj është lindur më 1956 në një familje të varfër fshatare. Në fëmijëri mbetet pa prindër. Ka 30 vjet që banon në qytetin e Pejës. Ka kryer Fakultetin Filozofik dhe është profesor i gjuhës dhe letërsisë shqipe në shkollën e mesme të Mjekësisë. Merret me letërsi dhe me aktivitete të tjera kulturore-artistike.

Pse do ta zgjedhte votuesi kosovar z. Dreshaj?

Ramë Dreshaj është i pavarur nga partitë aktuale, që i mundëson atij mbrojtjen e interesave të qytetarëve. Si kandidat i pavarur, ai beson se ka një vizion të qartë për të gjithë qytetarët e Kosovës multietnike, që do të ishte pjesë e strukturave evro-atlantike.

Platforma politike

Rinia dhe arsimit:

Kandidati Dreshaj, angazhohet për një rini të shëndoshë, të liruar nga urrejtja ndaj etnive tjera. Kosovës i duhet një rini që kërkon punë, e që do të largohet nga rruga, narkomania e prostitucioni. Në arsim, ai përkrahë zbatimin e reformave, luftimin e analfabetizmit dhe emancipimin e femrës, duke i dhënë asaj një rol më të rëndësishëm në shoqëri.

Zhvillimi ekonomik:

Ramë Dreshaj kërkon që t'i shpallet luftë "kapitalizmit politik" dhe klaneve mafioze politike të korruptuara. Hapja e fabrikave, zbutja e papunësisë, investimet e jashtme do të rezultojnë me zhvillimin ekonomik. Z. Dreshaj mbështetë hartimin e strategjisë afatgjate zhvillimore dhe krijimin urgjent të infrastrukturës për politikën makroekonomike.

Sbëndetësia dhe çështjet sociale:

Dreshaj angazhohet për mjekësinë familjare, organizimin e qendrave të maternitetit nëpër secilën komunë dhe pajisjen e tyre me aparaturat më moderne. Ai mbështetë një program social për të gjitha kategoritë e rrezikuara si dhe ndarjen e një fondi shtesë për këtë qëllim nga qeveria, duke i bërë apel dhe diasporës të ndajë mjete për të varfërit në Kosovë.

Të drejtat, interesat e komuniteteve dhe kthimi:

Dreshaj zotohet për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve dhe kthimin e të zhvendosurve. Pas kthimit, ai angazhohet që atyre t'u krijohen kushte për lirinë e lëvizjes. Nga organet gjyqësore, ai kërkon që të mbrojnë integritetin e minoriteteve nga sjelljet e individëve të caktuar ashtu edhe nga arbitrariteti i organeve shtetërore.

Kontakti: Rruga "Sanxhaku" p.n., Pejë ; Tel: +381 (0)63 7283 032; ramedreshaj@hotmail.com



48. GRAĐANSKA INICIJATIVA GORA – GIG

(Iniciativa Qytetare e Gorës)

Historia e shkurtër: Ky subjekt është themeluar në vitin 2000 si asociacion i qytetarëve dhe mori pjesë në zgjedhjet e vitit 2000. Në vitin 2002 u shndërrua në parti politike. Selia e partisë gjendet në Dragash. Thelbi i programit të kësaj partie është avancimi i

të drejtave dhe interesave të komunitetit Goran në Kosovë.

Biografia e shkurtër e kryetarit: Z. Rustem Ibishi është lindur më 3. 6. 1952 në fshatin Mlike, komuna e Dragashit, ku jeton edhe sot. Ai ka diplomuar në Historinë e Letërsisë së Popujve Jugosllavë në gjuhën serbo-kroate, në Universitetin e Shkupit. Ai punon si mësimdhënës në shkollën e mesme në Dragash.

Postet kryesore në qeveri:

Një vend në Kuvendin e Kosovës, brenda koalicionit VATAN, i cili ka fituar gjithsejt 4 vende në zgjedhjet parlamentare të vitit 2001. VATAN-i gjithashtu është plasuar në Qeverinë e Kosovës pas zgjedhjeve të vitit 2001, duke mbajtur postin e ministrit të Shëndetësisë për një vit. Përfaqësuesi i GIG-ut në Kuvendin e Kosovës, është anëtar i Komisionit për të drejtat e komuniteteve dhe Komisionit për çështje juridike, legjislative dhe të Kornizës Kushtetuese, ku deputeti nga GIG-u përfaqëson grupin parlamentar 'Komunitetet tjera'.

Pse do ta zgjedhte votuesi kosovar GIG-un?

GIG pason ekskluzivisht opcionin qytetar. Kjo është qasja për të zgjedhur problemet e grupit etnik që përfaqëson. Ngjashëm, GIG avokon qasjen e tillë edhe kur është fjala për grupet e tjera etnike në Kosovë.

Platforma Politike:

Rinia dhe Arsimi:

Arsimimi të bëhet në gjuhët rajonale dhe të minoriteteve, siç është e paraparë me Konventën për Gjuhët minoritare dhe rajonale.

Zhvillimi ekonomik:

Rivitalizimi i ndërmarrjeve shoqërore dhe stimulimi i iniciativave private. Krijimi i kushteve për punësim për pjesëtarë të komunitetit goran në sektorin shoqëror/publik.

Shëndetësia dhe çështjet sociale:

Shërbime shëndetësore dhe rehabilitim pa pagesë. Asistencë sociale për të rinjtë e papunësuar të cilët ngelin të papërfshirë në skemën e asistencës sociale të Kosovës.

Të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthimi:

Krijimi i kushteve që komuniteti goran të qëndrojë dhe punojë në Kosovë. Puna drejt eliminimit të çfarëdo lloj diskriminimi gjuhësor apo tjetërfare. Përmirësimi i lirisë së lëvizjes dhe shprehjes. Puna drejt zgjidhjes së çështjes së pasurisë së uzurpuar dhe krijimi i kushteve për kthim të qëndrueshëm. Një aspekt i kësaj të fundit është krijimi i kushteve për komunitetin goran të marrë pjesë në institucionet dhe administratën e Kosovës.

Kontakti: Z. Abdi Alia, GIG, kryetar i Komunës së Dragashit; Tel: 044 212 057.



49. BALLI KOMBËTAR I KOSOVËS - BK

Historia e shkurtër:

Balli Kombëtar i Kosovës është trashëgues i BK-së që është formuar në prill të vitit 1939 si organizatë kombëtare. Ky subjekt, si parti politike u themelua në Pejë në tetor të vitit 1991. Për shkak të programit politik, BK veprimtarinë e vet e ka ushtruar në ilegalitet. Gjatë kësaj kohe (1991-1999), anëtarët e BK-së janë burgosur e persekutuar. Pas vitit 1999, ky subjekt politik mbajti dy kongrese,

prej të cilave u zhvilluan organet partiake. BK vihet kundër nacionalizmit ekstrem dhe shovenizmit.

Biografia e shkurtër e kryetarit:

Prof. Dr. Sylejman Daka është lindur më 1945 në Kabash të Prizrenit. Është profesor ordinar në Fakultetin e Ndërtimtarisë në Universitetin e Prishtinës. Sylejman Daka është autor i studimit monografik universitar Sistemet Hidroteknike, dhe studime tjera nga kjo fushë.

Pse do ta zgjedhte votuesi kosovar Ballin Kombëtar?

Kultivimi i traditës, ndërgjegjes dhe edukatës kombëtare janë tiparet e këtij subjekti. BK vlerëson se është parti e trurit dhe etikës kombëtare. Mbi të gjitha ka njeriun e arsimuar dhe të drejtën e secilit për jetë dhe liri, duke mos njohur ngjyrën dhe racën e njerëzve. Kjo parti beson se të pandërgjegjshmit dhe amoralët kombëtarë e kanë vendin para gjyqit.

Platforma politike

Rinia dhe arsimi:

Reformat në sistemin arsimor, duke angazhuar intelektualët dhe të rinjtë në këtë punë, për BK-në janë rrugë e vetme përpara, duke kultivuar njëkohësisht traditat dhe vlerat kombëtare.

Zhvillimi ekonomik:

Zhvillimi ekonomik i Kosovës, bazuar në platformën e BK-së do të mbështetej në njohuritë e kapaciteteve të arsimurara në fushat adekuate të ekonomisë. BK mbështetë iniciativat e lira, privatizimin, angazhimin e njerëzve në punë dhe kalimin e pronës tek pronarët e ligjshëm. Po ashtu, kjo parti përkrahë dhe lejonin e kredive për shtëpi, vegla pune e bujqësore.

Shëndetësia dhe çështjet sociale

Më tepër se për çdo gjë, ka nevojë për shëndet. Kjo parti politike beson që reformat në shëndetësi duhet besuar njerëzve profesionistë në këtë fushë. Kurse zgjidhjen e problemeve sociale e shih përmes programeve të treguara të suksesshme në vendet e tjera në tranzicion.

Të drejta, interesat e komuniteteve dhe këmbimi:

Si një subjekt i përndjekur politikisht me vite të tëra, BK angazhohet që tani në Kosovë të krijohen kushte dhe të drejta e liri të barabarta për të gjithë. BK konsideron se në Kosovën e lirë dhe demokratike ka vend për të gjithë ata të cilët e duan Kosovën.

Kontakti: daut_bislimi@hotmail.com; Tel: +377 (0) 44 132 212; 038 550 372; 038 220 822 lokal 118



50. PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - PDK

Historia e shkurtër: PDK është themeluar në tetor të vitit 1999. Aktualisht, PDK është partia e dytë më e madhe në Kosovë. PDK-ja ka 36 degë aktive. Ajo ka përkrahje të fuqishme në tërë Kosovën. Sipas statutit të partisë, zgjedhja e Këshillit Drejtues dhe e kryetarit të partisë bëhet gjatë mbledhjes së Kuvendit të Përgjithshëm, që mbahet çdo 2 vjet. Këshilli Drejtues ka kompetencë të formojë Kryesinë e Partisë, e cila funksionon si organ ekzekutiv dhe angazhohet për zbatimin dhe ekzekutimin e vendimeve të marra nga Kuvendi i Përgjithshëm dhe Këshilli

Drejtues.

Biografia e shkurtër e kryetarit: Z. Hashim Thaçi është lindur në nëntor të vitit 1968 në Brojë, Skënderaj. Ka mbaruar Fakultetin Filozofik, Dega e Historisë në Universitetin e Prishtinës. Ai ka qenë Shef i Drejtorisë Politike të UÇK-së. Po ashtu, shef i delegacionit negociator të Kosovës në Rambuje (shkurt-mars 1999). Pas luftës z. Thaçi ishte kryeministër i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës.

Pozitat kryesore të mbajtura në qeveri: Kryeministër, ministër i Shërbimeve Publike dhe ministër i Tregtisë dhe Industrisë.

Pse do ta zgjedhte votuesi kosovar PDK-në? PDK-ja është parti që punon për politikë aktive dhe menaxhim më të mirë. Ajo mbështetë demokracinë e brendshme, transparencën dhe tolerancën. Përparësitë e PDK-së janë statuti dhe programi i saj, pastaj autoriteti i liderëve, përkrahja e të rinjve, struktura e anëtarësisë me të kaluar aktive për kauzën kombëtare. Energjia e partisë, transparenca dhe burimet njerëzore e bëjnë PDK-në unike në spektrin politik kosovar.

Platforma politike

Rinia dhe arsimi:

Prioritetet e PDK-së në këtë fushë janë përgatitja në nivelin më të lartë profesional për të rinjtë, angazhimi për më shumë mundësi për ta, siç janë punësimi, siguria dhe liria e qarkullimit. Njëherit, krijimi i bazës legale, reformat, ngritja e cilësisë dhe bazës materiale, pastaj arsimit privat, nxitja e konkurrencës dhe lidhshmëritë me ekonominë, po ashtu potencohen si angazhime të saj.

Zhvillimi ekonomik:

PDK mbështetë krijimin e programit ekonomik për tërë vendin. Ai program do të përfshinte sektorët stimulues për ekonominë e vogël e të mesme, krijimin e kushteve për investime, privatizimin e shpejtë dhe marrëveshje tregtare me shtetet tjera për ekonomi e fuqi punëtore.

Shëndetësia dhe çështjet sociale:

PDK-ja vihet në përkrahje të krijimit të infrastrukturës legale dhe teknike dhe aftësisë të stafit mjekësor për të mundësuar një gjendje më të mirë të sistemit shëndetësor. Gjithashtu, PDK është për sigurimin e qytetarëve të paaftë dhe atyre në gjendje të rëndë sociale. PDK do të angazhohet për kujdesje për pensionistët, fëmijët e dëshmorëve dhe invalidët e luftës.

Të drejtat, interesat e komuniteteve dhe kthimi:

PDK angazhohet që të drejtat e minoriteteve të rregullohen sipas standardeve ndërkombëtare, duke mbështetur barazinë qytetare, mundësinë për të drejtat kulturore, kushteve legale dhe të sigurisë për kthim të të gjithë qytetarëve nëpër shtëpitë e tyre.

Kontakti: Rr. "Nënë Tereza" nr. 20, Prishtinë; Tel: 038 223 769; info@pdk2004.org; www.pdk2004.org

Informacioni u sigurua nga: Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë së PDK-së



51. UNIONI DEMOKRATIK - UD

Historia e shkurtër: Unioni Demokratik është themeluar në prag të zgjedhjeve për pushtetin lokal në Kosovë në vitin 2002 me emrin Unioni Demokratik i Gjakovës (UDGJ).

Ky subjekt politik, fillimisht përfaqësonte interesat lokale. Ndërkaq, në vitin e saj të dytë, UDCJ vendosi të zgjerojë aktivitetin e saj në nivel të Kosovës. Kështu, UD ka vendosur të marrë pjesë në zgjedhjet e sivjetme parlamentare.

Biografia e shkurtër e kryetarit: Z. Mentor Kaçi u lind në Gjakovë me 7 qershor 1952. Ai ka studiuar Drejtësinë në Fakultetin Juridik të Prishtinës. Ishte punëtor shumëvjeçar në Radio Televizionin e Prishtinës. Ka qenë i burgosur dhe i dënuar politik më 1981 dhe 1991. Gjithsejt ka mbajtur 7 vite burg. Është themelues i Unionit Demokratik të Gjakovës dhe drejtues aktual i UD-së.

Pse do të zgjedhte votuesi kosovar UD-në?

Unioni Demokratik beson në Kosovën si një shtet modern, i cili do të pranohej në familjen evropiane. Shteti i Kosovës për UD-në nënkupton përfshirjen në botën e civilizuar, duke shmangur nacionalizmin dhe duke ofruar si alternativë më të mirë programet zhvillimore.

Platforma Politike

Rinia dhe Arsimi:

Rinia është obligim dhe pasuri e të gjithëve, prandaj kërkohet një zhvillim dhe edukim i mirëfilltë i saj. Unioni dëshiron të mundësojë dhe stimulojë që rinia e Kosovës të marrë pjesë dhe të vendosë në mënyrë të barabartë për të gjitha çështjet që ndërlidhen me fatin e tyre dhe të Kosovës. UD-ja angazhohet që programet shkollore të jenë të harmonizuara me programet ekonomike dhe kulturore të Kosovës, dhe të arrihen standardet evropiane.

Zhvillimi ekonomik:

Zhvillimi i institucioneve themelore të shtetit për UD-në nënkupton një çështje shumë të rëndësishme. Projekti i UD-së për shtetin konsiston në zhvillimin e qëndrueshëm institucional. Unioni Demokratik është i gatshëm t'i marrë përgjegjësitë e veta për të bërë kthesë në stabilizimin e gjendjes politike, ekonomike dhe çështjeve shtetërore të Kosovës.

Shëndetësia dhe çështjet sociale:

UD-ja angazhohet për një sistem efikas dhe ekonomik të sigurimit shëndetësor dhe hartimin e strategjisë afatgjate të shëndetësisë, duke u mbështur në elementin favorizues të politikës fiskale ndaj shëndetësisë. Unioni synon të hartojë programe sociale, të cilat do të mbrojnë familjet me fëmijë, pensionistet dhe veteranët.

Të drejtat, interesat e komuniteteve dhe kthimi:

Unioni Demokratik nuk ka ndonjë program të veçantë përkitazi me komunitetet në Kosovë dhe problemet e tyre aktuale. UD përkrahë të gjitha programet e bashkësisë ndërkombëtare, të cilat synojnë të përmirësojnë pozitën e minoriteteve në Kosovë. Komunitetet janë begati e veçantë e një vendi, andaj edhe Kosova nuk do të ishte Kosovë pa një spektër të këtyllë komunitetesh.

Kontakti: Unioni Demokratik, Rruga e UÇK-së, ish ndërtesa e Bankosit III/37; Tel.: 0390 23 789; +377 (0)44 207 332; www.unionidemokratik.org; info@unionidemokratik.org

Informacioni u sigurua nga: Mentor Kaçi, kryetar i UD-së



52. LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS – LDK (Democratic League of Kosovo)

Historia e shkurtë

LDK-ja është themeluar më 23 dhjetor 1989. Ka organizuar referendumin për pavarësi (1991), zgjedhjet e para dhe të dyta presidenciale dhe parlamentare (1992, 1998), jetën institucionale të Kosovës si dhe ka afirmuar Kosovën në botë. Ka organizuar dhe ka marrë pjesë në rezistencën për liri e pavarësi (1989-1999). Pas luftës, ka fituar shumicën në zgjedhjet lokale dhe qendrore (2000, 2001, 2002). LDK në Kosovë është e organizuar në 36 degë, 948 nëndegë dhe 1460 aktiva.

Biografia e shkurtë e kryetarit:

Dr. Ibrahim Rugova është lindur më 1944. Ai është kryetar i LDK-së që nga themelimi i saj. Ai ishte president i Republikës së Kosovës (1992-2000). Dr. Rugova është laureat i shumë çmimeve ndërkombëtare për paqe e liri dhe personalitet i nderuar kombëtar e ndërkombëtar. Dr. Rugova është President i Kosovës që nga viti 2002.

Postet kryesore në qeveri:

Pas luftës, LDK-ja ka pasur në Këshillin e Përkohshëm Administrativ pesë ministri (departamente). Pas zgjedhjeve nacionale (2001), ka dhënë presidentin e Kosovës, kryetarin e Kuvendit dhe katër ministra në qeveri. Drejton 18 komuna në nivel lokal të qeverisjes pas zgjedhjeve (2000, 2002).

Pse do ta zgjedhte votuesi kosovar LDK-në?

LDK dallohet me insistimin për njohjen e shpejtë të pavarësisë së Kosovës dhe është parti e besimit. Dallohet me fuqinë, organizimin dhe masovitetin e saj dhe i realizon premtimet e dhëna. Është parti e besnikërisë ndaj qytetarëve.

Platforma politike:

Rinia dhe arsimi:

Politikat e LDK-së janë: Edukimi modern i rinisë. Punësimi i të rinjve përmes projekteve të ndryshme ekonomike. Inkuadrimi i të rinjve në jetën politike e shtetërore. Dhënia e bursave për të rinjtë brenda dhe jashtë shtetit. Reforma e arsimit në përputhje me sistemin evropian. Arsimi më afër ekonomisë dhe politikës shtetërore dhe ekonomisë. Stimulimi i kërkimeve shkencore e teknologjike.

Zhvillimi ekonomik:

Stimulimi dhe garantimi i investimeve, privatizimi, koncesionet, anëtarësimi në institucionet financiare ndërkombëtare. Përshpejtimi i bartjes së kompetencave në fushën e ekonomisë. Krijimi i ndërmarrjeve të vogla e të mesme përmes kredive. Aktivizimi i industrisë së rëndë: energjetikës, minierës dhe prodhimeve të tyre.

Shëndetësia dhe çështjet e tjera sociale:

Krijimi i një ambienti të qëndrueshëm për shëndetësi dhe jetë sociale. Modernizimi i spitaleve, krijimi i një mjekësie të lartë. Sigurimi i pensionistëve, i të gjitha kategorive të invalidëve, të hendikepuarve, invalidëve të luftës. Ndihma për familjet e dëshmorëve.

Të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthimi:

Garantimi dhe mbrojtja e të drejtave të minoriteteve- komuniteteve dhe mbrojtja e tyre. Integrimi i tyre në shoqërinë dhe shtetin e Kosovës. Kthimi individual i të gjithë atyre që duan të jetojnë në Kosovë, duke krijuar siguri dhe mbrojtje, si dhe punësim e të mira sociale.

Kontakti: Rr. UÇK-së pa numër, Prishtinë; Tel: 038 242 242, 038 245 303; Fax: 038 245 305; kryesia_ldk@hotmail.com; www.ldk-kosova.org



53. KOSOVA DEMOKRATIK TÜRK PARTISI – KDTP (Partia Demokratike Turke e Kosovës)

Histori e shkurtër: KDTP është themeluar më 1990 dhe është regjistruar në UNMIK në vitin 1999. Selia e partisë gjendet në Prizren, dhe ekzistojnë degët lokale në Prizren, Mamushë, Prishtinë, Gjilan, Vushtri dhe Mitrovicë. Në Kuvendin e Kosovës KDTP ka fituar një ulëse dhe gjithashtu i ka edhe dy vende shtesë të rezervuara për komunitetin turk të Kosovës.

Biografia e shkurtër e kryetarit: I lindur në vitin 1961 në Prizren, z. Mahir Yagcilar është inxhinier i komunikacionit rrugor. Ai ka diplomuar më 1984 në Fakultetin e Trafikut dhe Komunikacionit në Universitetin e Sarajevës. Z. Yagcilar ka mbajtur pozitë menaxhuese në 'Kosovatrans', kompaninë më të madhe transportuese në Kosovë. Në prill të vitit 2000, ai është zgjedhur kryetar i KDTP-së. Z. Yagcilar ka qenë anëtar i Këshillit të Përkohshëm Administrativ dhe aktualisht është anëtar i Kuvendit të Kosovës.

Postet kryesore në qeveri:

Minstër i shëndetësisë dhe anëtarësia njëvjeçare në Kryesinë e Kuvendit të Kosovës gjatë mandatit të vitit 2001-2004.

Pse do të zgjedhte votuesi kosovar KDTP-në?

KDTP ekziston për ta ruajtur identitetin e komunitetit turk. Në veçanti, ky identitet pasqyrohet përmes ruajtjes së arsimit, gjuhës dhe kulturës të komunitetit turk në Kosovë. Përveç kësaj, KDTP punon për një jetë tolerante midis të gjitha komuniteteve në Kosovë, dhe është gjithmonë e gatshme që ta përkrahë këtë çështje.

Platforma politike në:

Rinia dhe arsimit:

Krijimi i më tepër mundësive për punësimin e rinisë, si dhe më tepër aktivitete sportive dhe kulturore. KDTP angazhohet që ta sigurojë arsimin universitar, jo vetëm në Kosovë, por edhe në Turqi dhe shtetet e tjera të rajonit dhe botës. Deri më tash, KDTP ka arritur që të sigurojë bursa për studime në Turqi për afërsisht 500 të rinj dhe të reja nga Kosova, në mesin e të cilëve shumica ishin nga komuniteti turk, mirëpo kishte edhe boshnjakë dhe shqiptarë të Kosovës që u përfshinë në këto programe.

Zhvillimi ekonomik:

Inkurajimi i investimeve nga jashtë, posaçërisht nga Turqia. Më tepër angazhim dhe investime duhet të futen në sektorin bankar dhe kreditor, që ka pësuar shumë gjatë viteve të krizës. KDTP do të avokojë për një shpërndarje të barabartë të vendeve të punës, në bazë të djes dhe shkathhtësive.

Shëndetësia dhe çështjet e tjera sociale:

KDTP do të përcaktohet për krijimin e njohurive më të mira mjekësore në Kosovë duke u përqendruar në specializimin mjekësor jo vetëm në Kosovë, por edhe jashtë saj. Përveç kësaj, KDTP do të angazhohet për një menaxhim më efikas dhe të automatizuar të objekteve shëndetësore në Kosovë, me rezultate më të mira, posaçërisht në raport me përfituesit e mirëqenies shoqërore.

Të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthimi:

Shfrytëzimi maksimal i përparësisë së dispozitave kushtetuese dhe ligjore, të cilat i sigurojnë të drejtat dhe interesat e pakicave, jo vetëm nga korniza e tashme ligjore por edhe në raport me këto të drejta që janë fituar në të kaluarën. Në veçanti KDTP përqendrohet në të drejtat gjuhësore, arsimin dhe zhvillimin kulturor si dhe traditën e komunitetit turk të Kosovës.

Kontakti: Mahir Yagcilar, kryetar; Tel. mobil: 044 173 360; Tel/fax: 029 42 534; kosova_dtp@yahoo.com; <http://www.kdtp.org>.



54. INICIATIVA QYTETARE BALLI KOMBËTAR DEMOKRAT - IQBKD

Historia e shkurtër:

Iniciativa Qytetare Balli Kombëtar Demokrat është subjekt politik që mëton të trashëgojë Ballin Kombëtar si organizatë e parë politike nacional-demokratike, e themeluar në prill të vitit 1939 nga një grup intelektualësh shqiptar të asaj kohe, të udhëhequr nga Mithat Frashëri. Pas Luftës së Dytë Botërore, aktivitetin e zhvilloi në emigracion, Evropë, SHBA e Australi. Më 1946 mori emrin Balli Kombëtar Demokrat, duke pretenduar të jetë vazhdimësi e të gjitha lëvizjeve shqiptare për bashkim kombëtar.

Biografia e shkurtër e kryetarit:

Z. Naser Bresa është lindur më 30 prill 1962 në Budrikë të Gjilanit. Ai diplomoi në Fakultetin e Shkencave Matematikore-Natyrore në Prishtinë. Më 1988 studimet postdiplomike i ka vazhduar në Zagreb, por regjimi i atëhershëm u kujdes që të ndërpresë këtë nivel të shkollimit. Aktualisht ushtron detyrën e mësimdhënësit dhe zhvillon aktivite të lidhur me mjedisin.

Pse do ta zgjedhte votuesi kosovar IQBKD-në?

IQBKD angazhohet për kultivimin e vlerave morale e zakonore, arsimim të vazhdueshëm si dhe për rritje të mirëqenies ekonomike. E profilizuar qartë si parti djathtiste, IQBKD e sheh vetën si një subjekt që ka karakter thellësisht kombëtar dhe ka qëllim bashkimin e trojeve etnike shqiptare në një shtet të vetëm.

Platforma politike

Rinia dhe arsimi:

Investimi në rininë si pjesën më të vlefshme të shoqërisë, për IQBK-në nënkupton angazhimin më të qëlluar, duke përfshirë këtu edukimin, kultivimin e tolerancës ndëretnike të të rinjtë dhe pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje. IQBK e konsideron arsimimin e rinisë si një domosdoshmëri për të arritur shkallën e zhvillimit të popullit. Një prioritet i veçantë i kësaj partie, është edhe angazhimi i saj që arsimimi të jetë falas, ndërkohë që mbështet edhe ekzistimin e shkollave private.

Zhvillimi ekonomik:

IQBKD angazhohet për zhvillim ekonomik, ku ekonomia e tregut dhe sektori publik do të plotësonin njëra tjetrën. Për të siguruar mirëqenien e qytetarëve në Kosovë, IQBKD angazhohet që tregtia dhe transporti vendor të mbahen në duart e instancave private, ndërsa pjesa e tregtisë dhe transportit ndërkombëtar të mbahet në duart e institucioneve publike.

Sbëndetësia dhe çështjet sociale:

IQBKD synon një shoqëri të shëndoshë, duke mëtuar angazhimin e profesionistëve në këtë fushë dhe furnizimin me gjithë aparaturën e domosdoshme moderne mjekësore. E mbështetë përmirësimin e mjekësisë familjare. Ndërsa për pozitën e rëndësishme sociale, kjo parti vlerëson se zgjidhja e gjendjes së vështirë gjindet te privatizimi, investimet nga jashtë dhe kthimi i pronës te pronarët e vërtetë.

Të drejtat, interesat e komuniteteve dhe kthimi:

IQBKD synon zgjidhjen e kësaj çështjeje duke luftuar çdo dhunë e diktaturë si dhe duke u angazhuar për njohjen e të gjitha të drejtave të pakicave, që garantohen me dokumentet ndërkombëtare. IQBKD nuk bën lëshim ndaj të drejtave të një minoriteti në dëm të interesave kombëtare dhe grupeve tjera etnike.

Kontakti: Sheshi Lidhja e Prizrenit, nr 4; balli_kom@hotmail.com; www.balli-kombetar.tk



55. PARTIA E DREJTËSISË - PD

Historia e shkurtër:

Partia e Drejtësisë është themeluar më 19 shtator të vitit 1999. Për herë të parë në zgjedhje doli në vitin 2001 dhe siguroi përfaqësim në Kuvendin e Kosovës me një deputet. Edhe në zgjedhjet lokale të vitit 2002 PD-ja garoi në

11 komuna, kurse aktualisht ka 22 degë dhe rreth 120 nëndegë të saj në tërë Kosovën.

Biografia e shkurtër e kryetarit

Z. Sylejman Çerkezi është lindur më 1 gusht të vitit 1968 në Kastriot (Obiliq). Mbaroi Medresën në Prishtinë dhe Fakultetin Filologjik në Universitetin e Prishtinës. Është i martuar dhe ka 2 fëmijë. Para vendosjes së misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, z. Çerkezi ka jetuar 8 vjet në Tiranë, ngase ishte i përndjekur politikisht. Aktualisht jeton në Obiliq.

Pse do ta zgjedhte votuesi kosovar PD-në?

Partia e Drejtësisë vlerëson se dallohet në skenën kosovare politike, duke u bazuar në vlerat morale të anëtarëve të partisë. Në programin e saj, PD nënvizon se dallon nga pjesa më e madhe e spektrit politik, ngase ajo angazhohet për bashkim kombëtar. Sikurse edhe në sloganin e saj, PD mbështetë mbrojtjen e interesave të bashkësive fetare. Ndërsa, kundërshton rreptësisht dukuritë si alkoolizmi, narkomania, korrupsioni dhe homoseksualiteti.

Platforma politike

Rinia dhe arsimi:

Partia e Drejtësisë e mbështetë futjen e edukatës fetare në shkolla, duke e konsideruar atë element qenësor të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Po ashtu, PD zotohet se do të gjente mënyra për krijimin e kushteve për rininë, që ajo të ndihet e lehtësuar shpirtërisht dhe fizikisht. Largimi i rinisë nga rrugët devijante, zë vend në mesin e prioritetëve të këtij subjekti politik.

Zhvillimi ekonomik:

PD-ja beson se problemi aktual i papunësisë së Kosovës do të mund të zgjidhet përmes punësimit të organizuar jashtë Kosovës. Kurse pikë e dytë e angazhimit të saj në përmirësimin e gjendjes ekonomike, veçohet krijimi i kushteve për huamarrje afatgjata për Kosovën.

Sbëndetësia dhe çështjet sociale:

Njohja e të gjitha të drejtave për të gjithë invalidët, sidomos ata të luftës. Ndalimi i abortit pas javës së 10-të të shtatëzanisë dhe masat parandaluese për sëmundjet ngjitëse, veçohen si prioritetet e PD-së në këtë fushë.

Të drejtat, interesat e komuniteteve dhe kthimi:

PD deklorohet për të drejta të barabarta për të gjitha pakicat në Kosovë. Duhet të krijohen kushte për kthim për të gjithë ata që kanë jetuar në Kosovë para vitit 1991 me përjashtim të kriminelëve të luftës.

Kontakti: Rruga "Rexhep Luci", Prishtinë; Tel:038-243-344; pd_kryesia@yahoo.com
;http://www.partiaedrejtjesise.com



56. PARTIA LIBERALE E KOSOVËS - PLK

Historia e shkurtër:

Partia Liberale e Kosovës është themeluar në vitin 1991. Ajo ishte e përfaqësuar në Parlamentin e Kosovës si institucion paralel gjatë viteve të '90-ta. PLK është e antarësuar në strukturat politike evropiane, ndërkombëtare nga viti 1997. PLK është anëtare e Internacionales Liberale dhe gjithashtu anëtare e Partive Liberale, Demokratike dhe Reformiste të Evropës (ELDR). Liberalët e Rinj të PLK-së janë gjithashtu anëtarë të strukturave liberale ndërkombëtare LYMEC dhe IFLRY.

Biografia e shkurtër e kryetarit:

Z. Gjergj Dedaj, sociolog, është kryetar dhe themelues i PLK-së. Gjatë karrierës së tij politike, ka qenë nënkryetar i Kuvendit të Kosovës në vitet 1998-1999. Pas vendosjes së Misionit të OKB-së në Kosovë, ai për një kohë ishte dhe anëtar i Këshillit Tranzitor të Kosovës. Është anëtar i Këshillit të ELDR-it dhe ishte kandidat për "çmimin e lirisë" të Internacionales Liberale me seli në Londër.

Pse do ta zgjedhte votuesi kosovar PLK-në?

Për PLK-në, vlerat evro-perëndimore si sundimi i ligjit, toleranca ndëretnike dhe anëtarësimi në strukturat evropiane e botërore janë prioritetet. Njëkohësisht, ajo angazhohet për ekonominë e tregut, privatizimin dhe për respektimin e të drejtave të njeriut. Fakti se PLK-ja është e antarësuar në ELDR dhe në Internationalen Liberale janë dëshmi e kredencialeve liberale të saj, orientimit të saj drejt Evropës Perëndimore dhe mundësisë dhe aftësisë për të bashkëpunuar me partitë politike të tjera të ngjashme.

Platforma politike

Rinia dhe arsimi:

Faktorizimi i rolit të rinisë, reformat në sistemin shkollor-universitar, punësimi dhe integrimi i rinisë në strukturat ndërkombëtare janë politika vepruese të PLK-së në këtë fushë.

Zhvillimi ekonomik:

Për një zhvillim ekonomik në Kosovë nevojitet ekonomia e tregut të lirë, privatizimi, investimet në mikro dhe makroekonomi. Prioritetet tjetër i liberalëve, do të jetë hapja e vendeve të reja të punës dhe investimet në prodhim e eksport.

Shëndetësia dhe çështjet sociale

PLK konsideron se të gjithë qytetarët e Kosovës duhet të kenë trajtim të garantuar shëndetësor dhe social, duke marrë si shembuj modelet e vendeve anëtare të BE-së.

Të drejtat, interesat e komuniteteve dhe kthimi:

Të drejtat njerëzore, e drejta për jetë, pronë dhe liri mbesin angazhime të liberalëve. PLK deklorohet gjithashtu se të gjithë qytetarët e Kosovës duhet të jenë të barabartë para ligjit. Liberalët zotohen se do të luftojnë diskriminimin etnik, duke garantuar kthim të qetë të të zhvendosurve në Kosovë.

Kontakti: Rruga Goleshi-Rexhep Luci, 10/2, Prishtinë; www.plk-kosova.org ; plk@ipko.org; +377(0)44 149 427



57. Dr. Xhevdet Rexhaj (kandidat i pavarur)

Biografia e shkurtër:

Dr.Xhevdet Rexhaj është i lindur në Cernicë të Burimit (Istog), më 1961. Ka doktoruar në Tenesi të SHBA-ve. Prej vitit 1988 merret me aktivitete humanitare. Ka ndihmuar qytetarë të Kosovës në periudha të vështira, duke shpërndarë ndihma, ndërtuar shtëpi për të pastrehët, duke u përkujdesur për fëmijë bonjakë e të hendikepuar. Ka ndihmuar renovimin e shkollave dhe të disa institucioneve shkencore si dhe botimin e shumë teksteve shkollore e universitare.

Pse do të zgjedhte votuesi kosovar z. Rexhaj?

Angazhimi në Parlament jashtë stereotipeve partiake i mundësohet atij pasi që nuk përfaqëson interesa të ngushta partiake. Rexhaj do të angazhohet për sendërtimin e strategjive dhe politikave të reja në fushëveprimin e Parlamentit. Ai do të fokusohet edhe në zgjidhjen e problemeve kyçe në shoqërinë kosovare, sidomos në fushën e ekonomisë, papunësisë, mbrojtjes sociale, posaçërisht të pensionistëve dhe invalidëve të punës e luftës.

Platforma Politike

Rinia dhe Arsimi:

Z. Rexhaj angazhohet për pjesëmarrjen aktive të rinisë në proceset shoqërore, duke caktuar kuotat e përfaqësimit të tyre në strukturat vendimmarrëse. Ai përkrahë punësimin e të rinjve dhe përshejtimin e reformave në arsim në të gjitha nivelet.

Zhvillimi ekonomik:

Z. Rexhaj angazhohet për krijimin e një kornize ligjore për zgjidhjen e çështjeve pronësore dhe kthimin e pasurisë së nacionalizuar dhe ekspropriuar. Mbështetë një model tjetër, më të mirë për privatizimin. Angazhohet për prodhimin vendor, duke u përqëndruar në bujqësi. Përkrahë gjithashtu eksportin dhe investimet e huaja.

Shëndetësia dhe çështjet sociale:

